

VLERA

REVISTË PËR FAMILJE DHE SHOQËRI

URIME
RAMAZANI
& FITËR BAJRAMIN

SEAN STONE

KONVERTOHET NË ISLAM

GOSTIA E ZOTIT

PLANET E MUAVIUT
SHEHADETI IMAM ALIUT

MARATONA ZGJEDHORE

AFTËSITË E MAGJISTARIT

VLERA

REVISTË PËR FAMILJE DHE SHOQËRI

Botues:

Instituti Kërkimor
Ndërkombëtar



KRYEREDAKTORE:

H.Ikballe Berisha Huduti
ikballebh@gmail.com

REDAKTORE:

Ardiana Ismaili

REDAKSIA:

Mr.Iris Robaj
Prof. Jetmir Çela
Dr. Emine Sh.Goxhuli
Fehmi Maliqi (përkthyes, analist)
Zehra Huduti (studente teologji)
Dafina Berisha

DESIGN:

MH

ADRESA:

Lagjja Veternik pa.nr.
Prishtina e Re - Prishtinë

Mob: 044/049 142 038

E-mail: vlera.magazine@gmail.com

www.vlera.net



Print: DinoGraf - Ferizaj

Tirazhi: 2000 copë

SPONSORED BY:

THE
WORLD
FEDERATION
OF KHOJA SHIA ITHNA-ASHERI MUSLIM COMMUNITIES



PËRMBAJTJA:

Editoriali.....	3
Kujt duhet ti përshtatet koha.....	5
Gostia e Zotit.....	6
Maratona zgjedhore.....	8
Filozofia e Islamit.....	10
Ekonomia Familjare.....	12
Femra kërkon mbikqyrje.....	13
Testamenti I të dërguarit.....	14
Sean Stone.....	16
Planet e Muaviut.....	20
Letërsia e Bejtenxhive.....	22
Instituti "Naim Frashëri".....	24
Mirësia.....	25
Veprat gjatë Muajit Ramazan.....	26
Fitër Bajrami.....	31
Ushqimet gjatë Muajit Ramazan.....	32
Shkurorëzimi.....	34
Pyetje dhe përgjigje.....	37
Dashuria dhe arritja e qëllimeve.....	39
Fjalët e Urta.....	40
Femrat e lira dhe të mjera.....	42
Eurodeputetja e parë me shami.....	44
Kuriozitete.....	45
Këndi poetik.....	46
Danimarka me Xhaminë më të madhe.....	47
Tregime të vërteta.....	48
World Federation.....	49

Editoriali

ME EMRIN E ALLAHUT, TË GJITHMËSHIRSHMIT, MËSHIRPLOTIT



“E kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë: “Unë, me të vërtetë jam mysliman.” (Sure “Fusilet”, ajeti, 33)

Të nderuar lexues, Revista Vlera ka nderin të prezantojë këto tema

të llojllojshme edukative nga mësimet e kulturës islame, të cilat janë mendime, studime, dituri të thella dhe të pastra nga Islami burimor pra shkolla e Ehlul Bejtit a.s, njëherit të ju urojë Festën e Fitr Bajramit.

Puna jonë është zëri përhapjes së Fjalës së Zotit të Madhëruar, Kur’anit të Shenjtë, traditës së pastër profetike si dhe kulturës së Ehli Bejtit pra Familjes së Pejgamberit s.a.a., duke qenë larg çdo fanatizmi verbues.

Këtë radhë për juve lexues të nderuar kemi përgatitur një artikull i cila përshkon me kohën dhe muajin në të cilin gjendemi, tema e radhës është:

LEXIMI I KURANIT FISNIK GJATË MUAJIT RAMAZAN

Vepra më e bukur, më e lavdëruar gjatë muajit Ramazan është leximi i librit të shenjtë Kuranit Fisnik, i cili ka zbritur i përmbledhur në këtë muaj, prandaj ne duhet t’i kushtojmë më shumë kohë dhe rëndësi të veçantë leximit të Kuranit Fisnik qoftë në gjuhën arabe apo në gjuhën tonë shqipe.

Kurani Famëlartë është libri hyjnor, vlen për të gjitha kohërat si dhe dispozitat e tij janë të vlefshme për të gjithë njerëzimin. Ai ka zbritur nëpër etapa dhe raste të njëpasnjëshme, si dhe në muajin e shenjtë të Ramazanit u përmbledh në Natën e Kadrit në zemrën e pastër të Pejgamberit Muhamed s.a.a.

Mësimi, leximi dhe studimi i Kuranit Fisnik nuk e për-

cakton dhe kufizon moshën, sepse adhurimi (ibadeti) më i pëlqyer është marrja e diturisë qoftë edhe në prag të vdekjes. Pejgamberi s.a.a. na ka këshilluar me fjalë mjaftë bindëse duke argumentuar se: **“Gjumi i dijetarit është më i mirë se namazi i të paditurit”** Gjithashtu Imam Sadiku a.s ka thënë; **“Është detyrim për njeriun që të mos vdes pa e mësuar Kuranin a.m., ose së paku vdekja ta takoj duke qenë në të mësuarit e shkronjave të Kur’anit a.m.”**

Për ta ndier në shpirt dobinë e leximit të Kuranit ne duhet të i përmbahemi ajetit Kuranor i cili thotë: **“Nuk e prekin atë përveç të pastërve”** sure el-vakia, ajeti 79. Sipas transmetuesve të mëdhenj të Kuranit ky ajet ka dy domethënie, domethënia e parë është se njeriu nuk ka të drejtë t’i prek shkrimet e Kuranit Fisnik pa pastruar veten fizikisht, kjo nënkupton marrjen e abdesit dhe mosqenia xhunub. Domethënia tjetër më e thellë është që nëse doni ta kuptoni Kuranin fisnik, duhet ta pastroni veten tuaj nga veset e liga dhe imoraliteti.

EFEKTET E LEXIMIT TË KURANIT

Leximi i Kuranit është pranvera e zemrës së njeriut, por dallojnë efektet e Kuranit në zemrat e lexuesve si dhe dëgjuesve. Në Kuran thuhet se atë e prekin të pastërtitë, gjithashtu edhe ne hadithe të Dërguarit të Allahut thuhet se leximi i Kuranit duhet bërë me sinqeritet dhe nga kjo vërtetojmë se është shumë me rëndësi pastërtia në lexim në mënyrë që të shijojmë kënaqësinë dhe begatitë e këtij Libër të Shenjtë.

Kur e lexojmë Kuranin në mënyrë automatike kuptojmë se ai lexim, apo ato fjalë vinë nga mendja jonë, nga goja dhe dalin jashtë në hapësirën ku gjendemi. Paramendojmë pra, nga cila mendje vjen, nga cila gojë kumtohet apo theksohet si dhe në cilin ambient dëgjohej? Nëse mendja jonë nuk ka mendime negative për të tjerët, nuk mendon keq për të tjerët, nuk është pesimiste, nuk bënë mëkate

duke paragjykuar, atëherë ajo mendje dha ai lexim dallon nga mendja dhe leximi i dikujt tjetër.

Pos mendjes, rrugë kaluese e fjalëve të shenjta është goja, pra, nëse goja jonë merret me thashë e thënie, fletë fjalë të kota, fjalë ofenduese, nënçmuese, shpifëse, gënjeshtër e tjera, atëherë këtu shihet dallimi dhe efekti i lexuarit të Kuranit nga njëri dhe tjetri lexues apo recitues. Për këtë na këshillon i Dërguari i Allhut duke na thënë: **”Pas-troni rrugët e Kuranit”, atij i thanë: -cilat janë rrugët e Kur’anit? Ai tha :”gojët tua”**.

Pra goja është organ lidhës mes Allahut dhe njeriut, prandaj një gjuhë e cila është e pastër nga fjalët dhe veset e këqija që i cekëm më lartë, atëherë ajo gojë ajo gjuhë e pastër gjatë recitimit të Kuranit e ka efektin më të bukur tek vetja e tij dhe tek të tjerët, si dhe ai person do të jetë i respektuar në rrethin ku jeton dhe në sytë e Allahut.

Gjëja tretë që të bënë të ndiesh kënaqësinë dhe efektet pozitive të Kuranit në zemrat tona, pra pas mendjes dhe gjuhës së pastër është vendi apo hapësira e pastër ku duhet të lexohet Kurani Fisnik. Në një shtëpi apo vend publik ku ka pastërti, si në objekte ashtu edhe në ajër, pastaj në ato shtëpi ku rrallë herë dëgjohen fjalë të banale, apo nuk ka muzikë degjeneruese nuk ka bërtima dhe grindje në mes familjarëve, por ka vepra të devotshmërisë, bëhen biseda jetësore pozitive, përmendet Allahu ore e çast dëgjoher aty këtu të lexuesit e Kuranit, atëherë ai mjedis apo ajo hapësirë këtë rast shtëpia, është element kyç që na mundëson ta shijojmë kënaqësinë dhe begatin e leximit të Kuranit Fisnik.

Është eminente tek besimtarët e devotshëm, anojnë kah ajo që të i kalojnë pushimet shpirtërore pran xhamive të shenjta, në Qabe, në Meke, në Medine pranë varrit të Pejgamberit s.a.a. , në Xhamitë shenjta të Imamëve a.s. ku i pushon turpi i tyre i rënë si shehid, me një qëllim që sa më shumë të lexojnë Kuranin dhe të përfitojnë edhe sevape edhe shpërblime të mëdha.

Pas recitimit të Kuranit në kemi disa nivele apo shkallë të të kuptuarit. Përsëmbull , nëse unë recitoj Bismil-lahir-rahmanir-rahm. Kjo vënie nga intelekti (mendja ime) ,

pastaj shkon në atë mjedis ku ka njerëz të cilët dëgjojnë, veshët gjithashtu kanë rëndësinë e vetë të posaçme se sa janë të pastër nga veset që i mëkatonin . Pastaj nga veshët e tyre leximi i Kurantit shkon në mendjet dhe në zemrat e tyre. Pra nëse veshët tonë nuk janë të ruajtura nga harrimet, thash e tharimet, përgjimet, atëherë definitivisht ajetet uranore nuk do të kenë efektin e vet as tek vet lexuesi as tek dëgjuesit që gjinden përreth tij. Këtu pra shohim dy lloje të veshëve si organ dhe shqisa të njeriut.

E kemi të njohur rrëfimin e Imam Aliut a.s. dhe një ushtari të plagosur në luftë. Ishte plagosur një shok i Imam Aliut paqja qoftë mbi të në fushëbetejë, në dyluftim iu këput krahu i tij, dhe ai lutej Allahut, **“ O Allah po ta kisha krahun timin në vend, do të luftoja edhe më shumë kundër dushmanëve Tu deri ë moment të fundit. “** Imam Aliu paqja qoftë mbi të e dëgjoi këtë lutje dhe dëshirë të shokut të tij, ju afrua ushtarit ia afroi dorën e këputur, dhe pas një kohe dora e plagosur plotësisht iu shërua bile bile ajo u bë me e fort se sa që ishte më parë.

Ushtari i habitur, e pyeti, - O i nderuri Imam ç'bërë, si e bërë këtë mrekulli, si është e mundur?

Imam Aliu -paqja qoftë mbi të, i tha: Unë e lexova suren Hamd – elhamdulilah rabil alemin. Ushtari u habitën dhe tha; ti e ke lexuar një sure të zakonshme dhe ke bërë një mrekulli të madhe, si është e mundur kjo !? Pas kësaj ushtarit përsëri i ra në tokë dora e këputur dhe Imam Aliu i tha: - Besimi, bindja jote, akidja jote, dhe rruga siç e ke dëgjuar këtë sure, dhe mendja jote ka menduar se është sure e zakonshme, prandaj nuk të dha efektin e duhur. Sikur ne të kishim dikë si Imam Ali paqja qoftë mbi të, me mendje gjuhë dhe veshë të bindur, me siguri se do të kishim bërë mrekulli mugjize me leximin e Kuranit. Nga kjo ndodhi e vërtet, mund të vijmë në përfundim se çdo lexues dhe dëgjues i ajeteve Kuranore ka dallueshmëri në efektin dhe dobitë që mund ti ket nga Kurani, përndryshe leximi i Kuranit pa pasur qëllime të këtilla do të ishte thjesht një libër leximi i padobishëm për njerëzinë.

Me du’a dhe respekt nga kryeredaktorja,
Ikbale Berisha Huduti



KUJT DUHET T'I PËRSHTATET

NJERIU HYN NË MAKINËN E KOHËS GJERSAMAKINA ËSHTË NË LËVIZJE . AI NUK DUHET PËR ASNJË MOMENT TA LË ANASH DREJTIMIN DHE KONTROLLIN E MAKINËS .




Duhet theksuar dy gjëra para se të fillojmë të diskutojmë lidhur me këtë çështje se, kujt duhet ti përshtatet koha. Njëra prej tyre është që shumë njerëz të cilët flasin për progresin, evolucionin dhe ndryshimet me rrethanat e tanishme mendojnë se çdo ndryshim që bëhet në kushte sociale, posaçërisht nëse vjen nga Perëndimi, duhet të konsiderohet evolucion dhe progres , e kjo është një prej ideve më devijante të cilat i kanë degraduar njerëzit.

Në bazë të qëndrimeve të këtyre njerëzve, pasi që kënaqësitë e jetës ndryshojnë nga dita në ditë me ç'rast të përsosurat i zëvendësojnë ato me më pak të përsosura, dhe ngase dituria dhe teknologjia janë në gjendje të progresit, të gjithë ndryshimet që ndodhin në jetën e njerëzve janë një lloj progresi dhe zhvillimi andaj duhet të priten duar hapur. Sepse, kjo është vrazhdë e kohës dhe, i pëlqeu kjo dikujt apo jo, është caktuar që kjo të ketë rrugën e vet. Në të vërtetë as këto ndryshime nuk janë rezultat direkt i diturisë dhe teknologjisë as është në vepër të ndonjë domosdoshmërie gjegjësisht zhvillimi.

Ndonëse dituria është në gjendje të progresit, nuk rrinë qetë karakteri tekanjor, grabitqar i njeriut. Dituria dhe intelekti e orientojnë njeriun drejt përsosmërisë, kurse karakteri tekanjor dhe grabitqar përpiqet ta tërheq kah shkatërrimi dhe devijimi. Karakteri i tij tekanjor dhe grabitqar përpiqet të bëjë diturinë armë të veten duke dashur ta shfrytëzojë këtë si për shkathtësi për apetitet e veta jetësore dhe shtazore. Koha brenda saj rrënohet dhe devijohet njësoj si progresi dhe evolucioni. Duhet shkuar para me progresin e kohës por njëkohësisht të luftohet kundër shkatërrimit dhe devijimit të kohës . Të dyja edhe reforma edhe reaksioni janë kundër kohës, me dallim që forma zë qëndrimin kundër degjenerimit të kohës kurse reaksioni qëndron si pengesë e progresit të kohës. Nëse çdo gjë duhet të harmonizohet me kohën, me çka pra duhet të harmonizohet koha? Nëse njeriu dhe ndryshimet e saj, i cili është roli i aktivitetit, kreativitetit dhe konstruktivitetit të dëshirës së njeriut?

Njeriu hyn në makinën e kohës gjersa makina është në lëvizje . Ai nuk duhet për asnjë moment ta lë anash drejtimin dhe kontrollin e makinës . Ata që flasin shumë për ndryshimet e kohës dhe e lënë anash drejtimin dhe kontrollin, harrojnë rolin e aktivitetit të njeriut dhe ngjasojnë më kalorësin i cili i nënshtrohet kontrollit të kalit.





Gostia

“ Muaji i Ramazanit është muaji në ë cilin u zbrit Kur’ani ”
- Sure Bekare

Muaji i Ramazanit është muaji më me vlera dhe më i bagatë. Ky muaji ku Zoti Fuqplotë i hap dyert e mëshirës së Tij për të gjithë njerëzit dhe fjala e Tij (Kur’ani), që është programi më i plotë udhëzues për lumturinë e njeriut, i’u zbrit profetit të madh Islamit në këtë muaj të bekuar. Padyshim, agjërimi në muajin e Ramazanit që është i vetmi muaj emri i të cilit është përmendur në Kur’an dhe që është quajtur “Gostia e Zotit“, dhe ashtu si principet e tjera të fesë islame, është një rast i volitshëm për t’i rikthyer trupit ekuilibrin dhe shëndetin dhe për të forcuar mënyrat e gabuara të jetesës. **Profeti i nderuar i Islamit ka thënë: “Agjëroni që të jeni të shëndetshëm”**

Çfarë është agjërimi ?

Agjërimi nuk nënkupton vetëm të ngrënit pak, por në fenë e pastër islame, agjërimi ka kuptime më të gjëra. Mosngrënia dhe mospirja, moskryerja e mardhënieve seksuale, mospërdorimi i duhanit dhe distancimi nga veprimet të qortueshme si përgojimi dhe mashtimi, gjatë një periudhe një mujore, nga i Dërguari i cili thekson : “ **Ai agjëruar që nga agjërimi fiton vetëm urinë dhe etjen, është si ai që rri zgjuar gjithë natën dhe nga ibadeti i natës fiton vetëm pagjumësinë .** ”

Sot është vërtetuar qartë se ngrënia e tepërt jo vetëm që dëmton shëndetin trupor të njeriut, por pengon dhe ngritjen shpirtërore të tij. Ngrënia e tepërt forcon tek njeriu ndjenjën e egoizmit, ambicies dhe arrogancës, dobëson dhe streson shpirtin duke krijuar një njeri të mposhtur nga epshet. Në lidhje me këtë, Profeti i nderuar (s . a . v . a), thotë:

“ Mos hani shumë ushqim, sepse ushqimi i tepërt dobëson forcën e gjykit në zemër, trupi bëhet i ngathët në bindjen ndaj Zotit dhe njeriu bëhet në zemër i shurdhër përballe këshillave të drejta “

Ndryshimet e natyrshme të trupit në kohën e agjëritimit Një prej pyetjeve më të shpeshta për njerëzit është pyetja: Vallë agjërimi është i dobishëm apo i dëmshëm? Për tu përgjigjur kësaj pyetje, së pari duhet të vërejmë se çfarë gëdosh në trup gjatë agjëritimit ose thënë ndryshe, të njohim

“ Fiziologjinë e agjëritimit ”

Fiziologjia e agjëritimit

Metabolizmi i ushqimit në trupin e njeriut ndryshon 8 orë pas konsumimit të vaktit të fundit të ushqimit. çfarë do të thotë kjo? Në kushtet normale glukozja që ekziston në trupin e njeriut dhe që rezervohet në mëlçi dhe në inde, konsiderohet si burim kryesor i energjisë së trupit. Kur uria zgjat rreth 8-14 orë, rezervat e glukozës shterojnë dhe yndyrat si burim i dytë i energjisë fillojnë të shfrytëzohen nga qelizat e trupit.

Zakonisht, ky process ndosh gjatë agjëritimit. Por nëse uria zgjatë më ditë të tëra, trupi për të fituar energjinë e nevojshme fillon të djegë proteinat që përdoren në strukturën e qelizave, indeve dhe skeletit të trupit dhe kjo padyshim që është e rrezikshme për shëndetin dhe jetën. Rastin e fundit e vërejmë më shumë tek personat e kequshqyer, tek të varfërit ose tek ata që kryejnë grevë urie për një kohë të gjatë. Në këtë rast, proteinat që ndodhen në inde çlirohen si pasojë e shpërbërjes së indeve dhe si rezultat, indet shaktërohen gjatë muajit të Ramazanit njeriu distancohet nga ushqimmi vetëm një muaj dhe afërsisht 8-14 orë (varet se në cilin stinë qëllon muaji i Ramazanit) dhe më këtë rast, trupin në vend që të konsumojë glukozë. Konsumi yndyra si burim kryesor energjie, ndërsa proteinat nuk preken dhe indet mbeten të shëndosha Si rezultat i djegjes së yndyrnave, ulet pasha e trupit dhe evitohen sëmundja të tilla të diabetit apo tensioni i gjakut dhe kjo është një nga i ftari e deri në syfyr të hajë e të pijë, por gjithmonë më masë. Ushqimi me masë apo i balancuar është ushqimi që përmban, yndyrat, vitaminat, kripërat dhe ujë në masë të mjaftueshme.

Agjërimi faktor i ngritjes shpirtërore dhe i qetësimin të mendjes

Sot, nga aspekti shkencor është vërtetuar se agjërimi jo vetëm që ndikon në ngritjen shpirtërore të njeriut, por edhe në qetësimin e gjendjes psikike dhe mendore të

e Zetit

tij. Është vërtetuar shkencëtarisht se në kohën e agjërit rritet ndjeshëm sasia e hormoneve si Androfonia në gjak, çka ndikon në pëmisimin e dukshëm të gjendjes shpirtërore dhe psiqike të agjëruarit. Kjo bëhet për shkak për një gjendje të qetësuar mendore tek njeriu dhe për rritjen e nivelit të përqendrimit të agjëruarit .

Agjërimi për fëmijët dhe nxënësit

Një nga pyetjet që preokupon prindërit është se në cilën moshë agjërimi nuk përbën rrezik për fëmijët? Burimet fetare dhe faktet shkencore theksojnë se fëmijët mund të fillojnë agjërimin në moshën e adoleshencës. Agjërimi para kësaj moshe varet nga niveli i durimit të fëmijës dhe nga situata e përgjithshme shëndetësore e tij. Nuk këshillohet agjërimi para moshës 7-8 vjeç, megjithëse është ide e mirë që fëmijët që në këtë moshë ti njohim me agjërimin. Përsëherë, agjërimi vetëm disa orë në ditë marrja pjesë në iftar me pjestarët e familjes dhe shokët krijon një ndjenjë pozitive tek fëmijët dhe përgatit atë nga aspekti fizik dhe shpirtëror për të mbajtur agjërim të plotë në vitet ardhshme. Nxënësit e shkollave fillore kanë nevojë për kujdes të veçantë. Në fakt, fëmijët e moshës 9-12 vjeç adoleshentët e moshës 13-18 vjeç janë në procesin e rritjes dhe nëse nuk marrin sasinë e nevojshme të ushqimit dhe energjisë, mund të përballen me pasojat të pariparueshme. Përdorimi i në sasi të madhe sheqeri nëpërmjet ëmbëlsirave me sherbet dhe yndyrat gjatë syfyrit bëhet shkak për uljen e glukozës në gjak në fillim të ditës dhe në këtë mënyrë bie efikasiteti i punës së nxënësve. Si rrjedhim, nxënësit që agjërojnë duhet:

1. Në programin e agjërit të respektojnë principet e ushqimit në 3 vakte ushqimore, iftar, darkë dhe syfyr .
2. Iftari për nxënësit duhet të jetë tepër i lehtë dhe me pak yndyrana .
3. Meqenëse vëllimi i stomakut në këtë moshë është shumë më i vogël se vëllimi i stomakut tek

të rriturit, patjetër duhet darka të hahet 2 ose maksimum 3 orë pas iftarit .

4. Është e domosdoshme ruajtja e ekuilibrit ushqimor gjatë iftarit, darkës dhe syfyrit .

5. Në çdo vakt ushqimor, nxënësit duhet të konsumojnë fruta dhe perime për shkak të vitaminave dhe kripërave që përmbajnë këto ushqime .

6. Konsumimi i një gote qumësht gjatë iftarit dhe syfyrit si dhe i një tasi kos në darkë dhe syfyr është tepër e këshillueshme për fëmijët dhe nxënësit agjëruar .

7. Megjithëse pjesa më e madhe e energjive tek nxënësit gjatë agjërit duhet të plotësohet nga buka dhe drithërat, konsumimi i lëndëve proteinike si mishërat dhe sidomos mishi i bardhë dhe veza dhe bulmetet është e domosdoshme për ta .

Të dashur nxënës: Asnjëherë mos agjëroni pa ngrënë syfyr dhe mos përdorni ëmbëlsira me sherbet dhe yndyrë dhe as pije të gazuara sidomos në kohën e syfyrit .

Të nderuar prindër:

Duhet të keni parasysh se në rast të mos zbatimit të regjimit të drejtë ushqimor nga fëmijët tuaj në periudhën e agjërit, fëmijët tuaj mund të përballen me pasojat të dëmshme si çrregullimi në procesin e rritjes, dobësimi trupor, shëndoshje e tepërt probleme kronike në aparatet e rritjes dhe në veçanti për vajzat mund të ketë pasojat në regjimin ushqimor të fëmijëve tek njëkët specialistët e në veçanti tek mjekët e regjimit



MARATONA ZGJEDHORE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

ANALIST: FEHMI MALIQI

Ata që duan ta dinë se cili do të jetë fundi i maratonës zgjedhore në Republikën e Kosovës, që nënkupton konstituimin e Kuvendit dhe të nominuarin për qeverinë e ardhshme, duhen të kenë fatin për ta pasur të afërt Enver Hasanin, ndërsa për ta ditur fituesin e botërorit Brazili 2014 duhet të dalin jashtë vendit për të kuptuar mos ka ndonjë kurdisje në nivel ndërkombëtar, dhe kështu për ta shuar pasionin e hazarderit dhe komplotistit në politikë dhe në sport.

Zgjedhjet e 8 qershorit u konsideruan se patën një përparim sa i përket rregullit zgjedhor, por jo edhe në dimensionin e keq përdorimit të parasë e mjeteve të tjera publike nga Filan Fisteku, fushata e të cilit kishte filluar para se të ishte dhënë çfarëdo ishareti zyrtar për zgjedhjet. Edhe pse nuk pati vjedhje industriale të votave, tani me të madhe po pritët që të kemi një interpretim vehabit të Kushtetutës, ndërkaq sinjali i parë për këtë u dha prej se kryetarja e Shtetit hoqi dorë para kohe për ta lexuar Kushtetutën dhe për t'i ushtruar kompetencat e saja, duke treguar kështu se në ekipin e saj ose ka jurist të paafte, apo edhe se nuk dëshiron në asnjë mënyrë të bëhet pjesë e ndonjë prapaskene, si rezultat i të cilave edhe vet ishte bërë kryetare. Edhe pse nuk bart as shami e as kapuç, kryetarja shumë herët tregoi se grerëza (e jo miza - siç thuhet në popull) i është ngatërruar flokëve.

Kryeministri që një Pavarësi të shpallur e degradoi me Ahtisari plus; me një proces bisedimor që deri më tani rezultoi me menaxhim të integruar të pritjeve të gjata në kufi; me fotokopje të librave të amzës, me të cilat as të gjallët nuk mund të konfirmohet se janë gjallë, as të

kurorëzuarit se janë bashkëshortë dhe as të vdekurit se a kanë vdekur me të vërtetë, ngase janë të dhëna të fotokopjuara sikur edhe megjet tona e fotokopjuara në librat e kadastrimit; frymë kjo e cila do të vazhdoj të mbretëroj edhe me një privatizim të egos, shkel e shko, dhe me një politikë anakronike në arsim.

Ndërkaq premtimi në fushatën e këtyre zgjedhjeve për 200 mijë vende të reja, është premtimi që nuk do të kishin guximin ta jepnin edhe ekspertët më të njohur në përmasat ndërkombëtare të fushës së ekonomisë dhe financave. Mirëpo në praktikën ballkanike kur nuk ka zhvillim real atëherë dalin në pah ëndrrat, përrallat, mitet, intrigat dhe gënjeshttrat. Secila nga këto mbushë njërin nga pjesët e ditës së një ballkanasi, ëndrra pjesën e parë të ditës - mëngjesin, përrallat pjesën e fundit të ditës - mbrëmjen, ndërkaq pjesa tjetër e ditës i mbetet miteve, intrigave dhe gënjeshtrave të cilat të thurura nga etërit e provincialit dalin sa të shëmtuara e qesharake, po aq të mjera dhe tragjike.

Deri sa në Shqipëri me të madhe flitet, se qeveria e atjeshme duke marrë nën kontroll Lazaratin, po e çmonton një shtet të kapur nga mafia e drogës dhe kimit, në Kosovë Vetëvendosje është duke dhënë maksimumin e saj që shteti i kapur nga partia -shtet t'i nënshtrohet rregullave demokratike ashtu që ndarja e përgjegjësiave mes më shumë faktorëve të unifikuar rreth një programi të përbashkët, po synon që për herë të parë të promovoj bashkëpunim kualitativ politik brenda shqiptarëve si asnjëherë deri më tani. Jo se deri më tani nuk kishte koalicione ndërpartiake që kishin qeverisur me Kosovën, por



tani kualiteti i unifikimit prek thelbin e çështjeve që as nuk janë tentuar të zgjidhen në rrugë të mbarë. Dialogu me Serbinë, integritet euroatlantike, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, privatizimi dhe zhvillimi ekonomik janë çështje të cilat po nuk u shtruan për zgjidhje mbi bazë të një strategjie të përpunuar e detajuar si duhet, do ta bëjmë edhe Kosovën si Shqipërinë e cila nuk ka as zhvillim e as stabilitet edhe përkundër se ka bërë një shekull jetë.

Pra synimi i Vetëvendosjes është që nga një luftë e egër për pushtet të kalohet në një përpjekje maksimale për shtetin e së drejtës, demokracinë e mirëfilltë institucionale dhe zhvillimin ekonomik që mbështet prodhimin. Ky tren ka marrë rrugën, ndërkaq kundërshtarët dhe skepticistët janë të vendosur që nëse nuk gjejnë qime në ve, aty të vendosin qimet o nga qerpikët o nga vetullat e tyre, vetëm e vetëm për ta penguar rrugëtimin e tij.

E nëse nisemi nga praktika ballkanike, alla shqiptarçe, ka të ngjarë që të fitojnë kundërshtarët e këtij rrugëtimi së bashku me skepticistët, përmes interpretimit vehabit të Kushtetutës, duke shkaktuar kështu ose zgjedhje të parakohshme ose një ndërhyrje të ndërkombëtarëve përmes ndonjë zarfi tjetër të nxjerrë nga shishja e Aladinit. Mbase qiribu - qiriba është edhe fati jonë ndër shekuj, duke pritur se mos diçka po pikë nga qielli apo nga të tjerët prandaj, për pasojë, te ne gjërat ndryshojnë në njëqind vjet - atëherë kur ndryshimi ndodhë, para së gjithash, për interesin e të tjerëve, ndërsa ne duke qenë pa strategji jemi vetëm se e mira apo dëmi kolateral i asaj lame.

Urojmë që as fituesi i botërorit "Brazili 2014" dhe as qeveria e re e Republikës së Kosovës të mos jenë produkt i hazarderëve dhe intrigantëve, por të jenë rezultat i lojës në fushë të futbollit dhe i votës së qytetarit në rutinë e votimit.

FILOZOFIA E ISLAMIT NË LIDHJE ME TË DREJTAT FAMILJARE

Dr. MURTEZA
MOTAHARI

Të tjerët thonë.....

Sikurse Islami femrën ta konsideronte si qenie të plotë njerëzore do të përcaktonte për të drejta të njëjta dhe të ngjashme , mirëpo ai nuk ka përcaktuar të drejta të njëjta dhe të ngjashme, prandaj ai nuk e konsideron femrën qenie të plotë njerëzore.

Çka themi ne.....?

Islami ka filozofi të posaçme e cila ka të bëjë me të drejtat familjare të mashkullit dhe femrës, e cila është në kundërshtim me atë që ka ndodhur në katërmbëdhjetë shekujt e fundit dhe asaj që po ndodh edhe sot. Islami nuk beson në një lloj të drejtave, një lloj të detyrimeve dhe një lloj ndëshkimit edhe për meshkuj edhe për femra në çdo rast. Ai konsideron se një grup ndëshkimesh është i përshtatshëm për meshkuj dhe femra, ndërsa një grup tjetër më shumë i përshtaten femrave. Pasojë e kësaj është që Islami në disa raste ka marrë qëndrim të ngjashëm në aspektin e femrave dhe meshkujve, kurse në rastin tjetër qëndrime të ndryshme.

Përse është kështu dhe cili është shkaku për këtë? A mos është kjo për shkak të asaj që Islami, si dhe shumë religjione të tjera, ka qëndrime përçmues ndaj femrës dhe femrën e konsideron lloj inferior apo, ndoshta, ka arsye të tjera dhe filozofi tjetër?

Ju mbase keni dëgjuar shumë herë në fjalime, ligjërata dhe shkrim të ithtarëve të ideve perëndimore se ta ligjet Islame që kanë të bëjnë me mehrin (dhuratën e martesës), përmbajtjen, shkurorëzimin, poligaminë dhe ligjeve të tjerë si këta i mendojnë si diçka që paraqet fyerje dhe se janë plot përçmim për gjininë femërore. Në këtë mënyrë, ata përpiqen të krijojnë përshtypje se këto përcaktime vetëm dëshmojnë se i është shkuar për shtati vetëm mashkullit. Ata deklarojnë se të gjitha rregullat dhe ligjet e botës para shekullit njëzet janë bazuar në përfytyrimin që mashkulli, falë gjinisë së vet, është qenie më fisnike se femra dhe se femra është krijuar për përdorim dhe dobi të mashkullit. E drejta Islame gjithashtu sillet në orbitën e njëjtë të interesave dhe dobive të mashkullit. Sipas tyre, islami është religjioni për meshkujt, se nuk e pranon femrën si qenie të plotë njerëzore dhe se nuk ka përcaktuar ligje për të që i janë të domosdoshme për një qenie njerëzore. Sikurse Islami të gjykon se femra është qenie e plotë njerëzore nuk do të mundësonte poligaminë, nuk do t'i jepte të drejtën e shkurorëzimit mashkullit, nuk do të konsideronte dëshminë e dy femrave ekuivalent me dëshminë e një mashkulli, nuk do t'ia jepte qeverisjen e familjes mashkullit, nuk do t'i lejonte femrës trashëgiminë në lartësi prej një gjysme të trashëgimisë së mashkullit, nuk do të mbështeste që femra ka çmim

në emër të mehrit (dhuratës së martesës), dhe nuk do të mundësonte pavarësinë e saj ekonomike dhe sociale, dhe nuk do të krijonte prej saj një pensionist të mashkullit i cili duhet ta furnizojë atë. Nga gjërat e thëna më sipër, ata deklarojnë se është konkluduar se si Islami ka pikëpamje poshtëruese ndaj femrës dhe se e konsideron mjet për krijimin e më shumë njerëzve dhe si kusht të domosdoshëm për këtë. Ata shtojnë se përkundër faktit që Islami është religjioni i barazisë dhe ndonëse e preferon barazinë në situatë të tjera, në rastin femrës dhe mashkullit ai nuk përmbahet kësaj. Ata deklarojnë se Islami ka mbështetur të drejtat diskriminuese dhe të privileguara për meshkujt. Sikurse të kishte për bazë të drejtat diskriminuese dhe privileguara për meshkujt, nuk do të urdhëronte ligjet e përmendura më sipër. Nëse e shpërblejmë argumentin e këtyre zotërinjve në modelin logjik Aristotelian , do të ketë këtë formë:

Sikurse Islami femrën ta konsideronte si qenie të plotë njerëzore do të përcaktonte për të drejta të njëjta dhe të ngjashme , mirëpo ai nuk ka përcaktuar të drejta të njëjta dhe të ngjashme, prandaj ai nuk e konsideron femrën qenie të plotë njerëzore.

Barazi ose njëjtësi?

Kuptimi bazë i cili përdoret në këto argumente është ai që është e domosdoshme pasoja e pjesëmarrjes së mashkullit dhe femrës në dinjitetin dhe nderit njerëzor qëndron në atë që të drejtat e tyre do të duhej të ishin të njëjta dhe identike. Tani çështja të cilën, thënë në mënyrë filozofike, do të duhej dëshmuar se është përcaktim i saktë cila është ajo pasojë e domosdoshme e pjesëmarrjes së mashkullit dhe femrës në dinjitetin njerëzor. A ka nevojë për konkludimin se cili prej tyre do të duhej të kishte të drejta ekuivalente me ato të tjetrit atë që mos ketë përparësi dhe privilegj në favor të njërit prej tyre apo ndoshta është e domosdoshme që të drejtat e mashkullit dhe femrës, pos asaj që janë identike dhe të barabarta, gjithashtu të jenë saktësisht të njëjta dhe se nuk do të duhej të kishte ndar-



je në asnjë punë apo detyrë. Pa dyshim që pjesëmarrja e mashkullit dhe e femrës në dinjitetin njerëzor dhe identiteti i tyre si qenie njerëzore kërkon që ata të kenë të drejta të barabarta njerëzore, porse si mund të ekzistojë identiteti i të drejtave?

Nëse e lëmë anash imitimin dhe animin e verbër kah filozofia perëndimore dhe lejojmë vetes të gjykojmë për ide të filozofike dhe qëndrimet që na kanë ardhur prej tyre, fillimisht duhet të par nëse është identiteti i të drejtave ose jo i domosdoshëm për barazinë e të drejtave. Barazia e të drejtave është e ndryshme nga njëjtësia e të drejtave. Barazia e të drejtave paraqet barazi dhe paanësi, ndërsa njëjtësia nënkupton se këto të drejta janë pikërisht të njëjta. Është e menduar që babai t'ua ndajë pasurinë njësoj dhe drejt bijve të vet, por ai nuk është i detyruar të ndajë në mënyrë identike. Për shembull, është e mundur që babai ka lloje të ndryshme të pasurisë: mund të posedoj një firmë komerciale, një tokë të punueshme dhe patundshmëri; me që ka biseduar me djemtë, ka zbuluar tek ata talente të ndryshëm, për shembull, ka mundur të zbulojë se njëri prej tyre ka afinitet për punë komerciale, i dyti është i talentuar në bujqësi, djersa i treti ka afinitet të administrojë me patundshmëri. Kur vjen deri te ajo që duhet ndarë pasurinë bijve për së gjalli, duke pasur parasysh që ai bijve duhet t'u japë njësoj në formë të vlerës së pronësisë dhe se nuk guxon të privilegjojë as diskriminonjë, në teste të pasurisë sipas talentit të cilin e ka zbuluar tek ata.

Kuantiteti dallon nga kualiteti. Barazia është e ndryshme nga ajo që të jetë tërësisht e njëjtë. Ajo gjëja që është e ditur që islami nuk konsideron se duhet domosdo të ketë njëjtësi gjegjësisht identitetin i saktë i të drejtave në mes meshkujve dhe femrave, mirëpo kurrë nuk ka besuar në privilegje dhe diskriminim në dobi të mashkullit dhe kundër femrës. Islami, gjithashtu, e mbështet parimin e barazisë midis mashkullit dhe femrës. Islami nuk është

kundër barazisë së mashkullit dhe femrës, por nuk pajtohet me njëjtësinë e të drejtave të tyre.

Fjala "njëjtësi" dhe "barazi" kanë marrë njëfarë lloj shenjtërie sepse përfshijnë domethënien e fjalës "vlerë e njëjtë" dhe "mosekzistim i diskriminimit". Këto fjalë janë atraktive dhe tërheqin vëmendjen e dëgjuesve, posaçërisht kur këtyre fjalëve u shoqërohet fjala "e drejta".

"Barazia e të drejtave" - sa e bukur dhe shenjtë është ky kombinim i fjalëve! Nuk mund të ketë një njeri i vetëdijshëm dhe ndjenjë origjinale morale që nuk do të respektonte këto fjalë.

Por si është e mundur që ne, që njëherë kemi qenë bartës të diturive standarde, filozofisë dhe logjikës, kemi ardhur në pozitë të tillë që të tjerët duan të na imponojnë qëndrimet e veta e të për njëjtësinë e të drejtave të mashkullit dhe femrës në emër të fjalëve të shenjta-barazi dhe njëjtësi.

Kjo është saktësisht si kur dikush do të dëshironte ta shiste një rrepë të zier duke e quajtur dardhë. Ajo që del qartë është se Islami nuk ka lejuar të drejta të njëjta për meshkuj e femra në gjithçka, njësoj siç nuk i ka përcaktuar detyrime dhe ndëshkime të njëjta për të parët dhe për të dytët në të gjitha rastet. A është shuma e të gjitha të drejtave që janë vënë për femrat më i vogël për nga vlera se të drejtat që u janë lejuar meshkujve? Natyrisht që jo, siç do të dëshmojmë. Këtu paraqitet një pyetje tjetër. Përse Islami lejon të drejtat e barabarta për meshkuj dhe për femra në disa raste? Përse nuk u ka lejuar drejta të njëjta dhe të parëve dhe të dytëve? A nuk do të ishte më mirë që të drejtat të jenë njësoj por jo edhe të njëjta?

Në numrin tjetër të Revistës VLERA do të keni mundësin të lexoni temën lidhur me atë se cili është shkak i ekzistimit të dallimeve që ekzistojnë në krijimin e mashkullit dhe femrës? A janë këto dallime shkak i ekzistimit të pabarazisë në të drejtat e tyre të natyrshëm apo jo?

€KONOMIA FAMILJARE

"Atij që shpenzon me masë i garantoj se kurrë nuk do të bëhet i varfër".

Të përkujdesuri për nevojat e gruas është vaxhib (obligim) për burrin. Gjegjesisht burri është i obliguar t'i paguajë shpenzimet e gruas së vet siç janë: ushqimi, veshmbathja, banesa, mjekimi dhe barërat. Do të bëjë gabim nëse nuk e përmban bashkëshorten e vet dhe mund të dënohet me ligj.

Nuk mund të pritët që familja të jetojë pa asnjë harxhim. Të gjithë kanë nevojë për ushqim, barëra, veshmbathje dhe për vendbanim. Por, ato mund të kërkojnë gjëra të panevojshme, e në atë rast burri mund të mos i dëgjojë dhe mos tu nënshtrohet dëshirave të tyre të lloj-llojshme. Njeriu i mençur do të harxhojë në bazë të të ardhurave. Ai patjetër të bëjë klasifikimin e gjërave, dhe t'i ofrojë ato sipas principit të prioritetit sa herë që të ketë mundësi. Ai, gjithashtu, duhet të ruajë ndonjë para për ditë të zeza. Disa para duhet patjetër të ndahen për qira ose për blerjen e banesës së re. Nuk duhet të harrojë rrymën elektrike, ujin, gazin ose pagesat e telefonit. Tatimi patjetër duhet paguar, por edhe shkollarisën nuk duhet harruar. Duhet t'u ik harxhimeve të tepërta dhe nuk guxon të harxhojë për gjërat e panevojshme. Mbajtja e llogarisë për shpenzime kurrë nuk do ta sjellë njeriun gjer te bankrotimi dhe borxhi.

Harxhimin me masë All-llahu i Lartësuar e konsideron si dëshmi e imanit (besimit) dhe në Kur'anin Famëlartë thotë:

"Dhe ata, të cilët kur shpenzojnë nuk derdhnin e as janë tepër dorështrenguar, por në këtë mbajnë mesataren" (25:67).

Imam Sadiku paqa qoftë mbi të, ka thënë: "Atij që shpenzon me masë i garantoj se kurrë nuk do të bëhet i varfër".

Imam Sadiku, gjithashtu ka thënë: "Ka katër grupe njerëzish, lutjet e të cilëve nuk do të pranohen. Një ndër ata është edhe personi i cili harxhon pasurinë e vet, e pastaj i lutet All-Allahut të Gjithëfuqishëm: O All-llah më furnizo! Atëherë All-llahu i përgjigjet: "A nuk të kam urdhëruar të jesh i matur në harxhime".

Abdullah ibën Ebi Abbasi ka thënë: "E pyeta Musa ibën Ebi Xha'ferin për mirëmbajtjen e familjes, e ai tha: Harxhimet e tepërta dhe koprracia janë të papëlqyeshme. Njeriu nuk guxon ta humbasë maturinë".

Njeriu i mençur do të largohet që të mos huazojë ose të marrë borxh për gjëra të parëndësishme. Ekonomia e cila bazohet në borxhe (me kamatë) të marruar nga banka dhe nga institucionet e tjera, edhe sipas Islamit edhe sipas logjikës është gabim dhe e papëlqyeshme.

Blerja e gjërave në bazë të pagesës me këste, edhe pse kontribuon që shtëpia juaj të duket e bukur, ua merr juve komforin dhe qetësinë shpirtërore. Për se të blejë njeriu

gjëra të panevojshme me çmime të larta e t'ia mbush bankierit xhepat me këste? Çfarë jete është ajo kur gjithçka blihet me këste? Po a nuk është më mirë për njeriun që të pres dhe ta ruajë paranë e vet me qëllim që të blejë gjëra me çmime më të lira?

Është e vërtetë se paraja fitohet me vështirësi dhe se ndikon në jetë, por shumë më e rëndësishme është mënyra se si njeriu e harxhon paranë e vet. Ka familje që kanë të ardhura të mira e që gjithnjë janë në borxh. Gjithashtu, ka familje që kanë të ardhura modeste e që jetojnë komfor. Ato dallohen në mënyrën se si i harxhojnë të ardhurat e veta. Mu për këtë, më mirë për familjen është që burri apo gruaja që mendojnë mirë si më lartë, ta marrë kontrollin mbi harxhimet apo ta mbikëqyrë atë që është përgjegjës për të.

Në fund përkujtojmë se koprracia gjithashtu është e keqe sikur derdhja. Nëse njeriu ka fitim më të madh, ai patjetër duhet që jetën e familjes ta bëjë më të këndshme dhe t'ia plotësojë asaj nevojat themelore në masë më të madhe. Pasuria dhe paratë janë për t'u harxhuar dhe për sigurimin e nevojave jetësore e jo të grumbullohen e të mbeten pas tij kur të shpërngulet në botën tjetër (të vdes).

Pasuria patjetër të hetohet në familje e në shtëpi. Çfarë dobie ka nëse punoni me zell e nuk harxhoni? Njeriu patjetër ta shfrytëzojë pasurinë e tij dhe ajo patjetër të ndikojë në familje dhe në konforin e tij. E pahijshme është të shohish dikë që është i aftë e fiton, ndërkaq fëmijët e tij janë të etshëm për ushqim të mirë e për rroba të mira. Fëmijët e një personi koprrac do të presin vdekjen e tij në mënyrë që ta ndajnë pasurinë e tij. Nëse dikujt All-llahu i Gjithëfuqishëm i ka dhuruar begati, ato patjetër duhet të shihen në jetën e tij.

Pejgamberi s.a.a. thotë: "Nuk është prej nesh (prej ithtarëve të Pejgamberit s.a.a.) ai që posedon para, ndërsa familjen e vet e mban larg pasurisë së tij".

Musa ibën Xh'aferi r.a. ka thënë: "Anëtarët e familjes varren nga mashkulli. Prandaj kushdo që i ka dhuruar Allahu nga begatitë e veta, duhet që të harxhojë për konforin e atyre që varen prej tij ose, përndryshe këto të mira mund t'i ndërpriten".

Imama Riza-paqa qoftë mbi të ka thënë: "E lëvdur është që njeriu anëtarëve të familjes së vet t'u sigurojë, me paratë e veta konfor, në mënyrë që të mos presin vdekjen e tij".

Imama Aliu a.s. ka thënë: "Siguronie ujin për çdo javë për ata që janë të varur nga ju kështu që të mund të gëzohen për javën që pason".

FEMRA KËRKON MBIKQYRJE

Zonja psikologe **Cleo Dalsen** deklaroi se tërë jetën është e interesuar për studimin e mentalitetit të meshkujve në atë masë, në të cilën mund të bëjë këtë një psikologe femër. Në të kaluarën e më hershme, thotë ajo, ka qenë e autorizuar të studiojë faktorët psikologjikë tek femrat dhe meshkujt dhe ka ardhur në përfundim vijues:

Të gjitha femrat dëshirojnë të punojnë nën mbikëqyrjen e dikujt. Me fjalë të tjera ato preferojnë të punojnë si vartëse, nën mbikëqyrjen e dikujt që është epror.

Të gjitha femrat dëshirojnë të ndjejnë që ekzistenca e tyre është kreative dhe se, në të vërtetë, janë të dobishme.

Pas kësaj, zonja në fjalë thekson mendimin e vet. Ajo pohon se si është bindur se këto dy dëshira i kanë rrënjët në faktin se femrat janë nën ndikimin e ndjenjave vetjake gjersa meshkujt e ndjekin arsyen. Shumë shpesh mund të vërehet, vazhdon ajo, që femrat nuk janë të barabarta me meshkujt sa i përket intelektit, por nganjëherë më të mira se ata. Pika e vetme e dobët te femra është intensiteti i ndjenjave. Meshkujt gjithnjë mendojnë në mënyrë praktike, arrijnë rezultate më të mira, janë organizatorë më të mirë dhe ofrojnë udhëzime të mira. Kështu që epërsia mentale e mashkullit ndaj femrës, mendon ajo është diçka më e planifikuar nga natyra. Sado që femra lufton kundër një

gjendje të tillë, nga ajo nuk ka dobi. Meqenëse se janë më të ndjeshme se meshkujt, femrat do të duhej ta pranojnë realitetin e në jetët e tyre u nevojitet mbikëqyrja e mashkullit. Qëllimi më i rëndësishëm në jetën e femrës është siguria dhe kur arrin të përmbushë këtë qëllim, punon së qenit aktiv. Femra ka frikë nga ballafaqimi me rreziqet që janë përfshira në rrugën e arritjes së qëllimit të saj. Frika është ndjenja e vetme tek e cila kanë nevojë për ndihmë që ta eliminonë. Detyrat të cilat kërkojnë mund të madh mental për femrat janë të mërzitshme dhe i anashkalojnë.

RESPEKTI PËR LIGJIN

Për rehatinë dhe sigurinë e popullatës, ligjet janë të nevojshme. Kur ne e kuptojmë përparësinë e veprimit në përputhje me ligjin, atëherë do bëhemi qytetar të mirë.

Në shoqërinë e civilizuar, njerëzit nuk mund të jetojnë pa ligje. Aty ku mbisundon ligji i xhunglës, aty nuk ka shoqëri të civilizuar. Për udhëheqjen e mirë të administratës shoqërore, të rëndësishme esenciale janë ligjet e përcaktuara në mënyrë të drejtë. Këto ligje shërbejnë për mirëmbajtjen e rendit dhe për të siguruar ndëshkimin e merituar dhe adekuat për fajtorët. Për rehatinë dhe sigurinë e popullatës, ligjet janë të nevojshme. Në vendet ku ka mirëkuptim në mes të njerëzve dhe ligjvënësve, ligjet nxirren për levendin e njerëzve, prandaj edhe ata i respektojnë këto ligje. Në një shtet mund të ketë mbarëvajtje të përgjithshme nëse populli i atij vendi i nënshtrohet ligjit.

Në vendet ku ligjvënësit punojnë me motive të fshehta egoiste dhe gjatë formimit të ligjit nuk e kanë ndërmend mbarëvajtjen e njerëzve, aty njerëzit nuk nderojnë ligjin dhe në atë shoqëri paraqiten pakënaqësitë.

Respekti për ligjet legjitimet për të mirën e popullit është esenciale dhe prindërit duhet t'u shpjegojnë fëmijëve këto. Kur fëmija vëren se prindërit e kalojnë rrugën vetëm prej vendkalimit të këmbësorëve, ai do të kuptojë se edhe ai duhet të bëjë të njëjtën. Ai do të pranojë shprehinë e ndjekjes së ligjeve të sigurisë dhe asnjëherë të mos t'i shkelë ato.

Prindërit duhet t'u tregojnë fëmijëve se automobilat dhe mjetet tjera lëvizëse e kanë të drejtën e lëvizjes nëpër rrugë dhe këmbësorët mund të shfrytëzojnë vetëm kalimin e këmbësorëve kur dëshirojnë të kalojnë në anën tjetër të rrugës. Këmbësorët që e anashkalojnë këtë rregull bëjnë kundërvajtje dhe janë të ekspozuar rrezikut të fatkeqësisë.

Kur fëmija të kuptojë përparësinë e veprimit në përputhje me ligjin, ai do bëhet një qytetar i mirë.

Imam Aliu a.s. Urdhëruesi i Besimtarëve thotë:
“ Shprehinë janë natyra e dytë e njeriut ”

TESTAMENTI I TË DËRGUARIT TË ZOTIT KUSHTUAR IMAM ALIUT

Pejgmaberi paqja qoftë mbi të dhe Familjen e tij, çastet më të këndshme të jetës i kalonte me dhëndërinë e tij Imam Aliun paqja qoftë mbi të, duke e këshilluar me këto dituri të shenjta profetike.

O Ali, shenjat e arritjes së bindjes së sigurt (jakin) janë këto: Mos e kënaq askënd me ndonjë gjë që e zemëron Allahun, mos e lëvdo askënd për ndonjë gjë që të ka dhënë Allahu dhe mos e kritiko askënd për ndonjë gjë që nuk të ka dhënë Allahu. Sepse, furnizimi nuk mund të fitohet përmes lakmisë dhe nuk mund të parandalohet përmes kërkesës.

O Ali, nuk ka varfëri më të keqe se sa padituria, pasuri më të madhe se mendja, vetmi më frikuese se egoizmi dhe ndihmesë më të madhe se konsultimi. Asnjë mendje nuk është më e dobishme se sa mendja e kujdesshme. Nuk ka origjinë dhe prejardhje më të mirë se sa morali (ahlak), dhe nuk ka adhurim (ibadet) më të mirë se sa falënderimi.

O Ali, fjalën e shkatërron gënjeshtria, diturinë e shkatërron harresa, pakujdesia e shkatërron adhurimin, bujarinë e shkatërron neglizhenca, trimërinë e shkatërron zullumi, bukurinë e shkatërron egoizmi dhe prejardhjen familjare e shkatërron të lëvduarit me të.

O Ali, gjithmonë thuaje të vërtetën; mos të dalë e pavërteta asnjëherë nga goja; kurrsesi mos tento kah tradhtia; frikësohu nga Allahu sikur je duke e parë Atë; pasurinë dhe jetën flijoje për fenë tënde; përfito sjelljen e mirë dhe largohu nga sjellja e keqe.

O Ali, tri gjëra janë prej moralit të lartë: Të punosh në vazhdimësinë e lidhjes me atë që e ka ndërprerë me ty; t'i dhurosh atij që nuk të jep dhe të falësh atë që të bën zullum.

O Ali, tri gjëra janë shpëtuese: Përmbajtja e gjuhës, qarja për mëkatet dhe mosdalja nga shtëpia (duke pasur për qëllim largimin nga shoqërimi me njerëzit e pamoralshëm).

O Ali, këto tri kualitete morale vijnë në krye të çdo veprë: Sjellja me drejtësi ndaj njerëzve (edhe nëse është kundër interesave personale), mirëmbajtja e barazisë me vëllain tënd besimtar dhe të përmendurit e Allahut në çdo gjendje.

O Ali, tre persona janë mysafirë të Allahut:

-Besimtari i cili e viziton vëllain e vet vetëm për hir të Allahut. Njeriu i tillë është vizitori i Allahut dhe, shërbimi

dhe plotësimi i dëshirës së vizitorit është një e drejtë që i takon Allahut.

-Mysafiri i Allahut është edhe ai që, pasi ta falë namazin, është i zënë me lutje, përmendje të Allahut (dhikr), lexim të Kuranit, etj. deri në namazin e ardhshëm. Edhe për personin e tillë, shërbimi dhe plotësimi i dëshirës së tij është një e drejtë që i takon Allahut.

-Dhe, personi që është në haxh dhe umre. Këta persona janë duke e vizituar Allahun dhe mikpritja për ata i takon vetë Allahut.

O Ali, tri gjëra kanë shpërblim në këtë dhe në botën e ardhshme: Haxhi, që e mbulon varfërinë; lëmosha (sadaka), që i largon fatkeqësitë; dhe, bamirësia ndaj të afërmeve, që ta zgjatë jetën.

O Ali, tri gjëra të çojnë drejt rrugës së mirësisë: Bujaria, të folurit e bukur dhe të qenët i durueshëm ndaj fatkeqësive.

O Ali, në Tora janë shënuar katër gjëra, që i bartin katër gjëra tjera: Kush e lakmon botën, zemërohet në Allahun; ai që ankohet prej një fatkeqësie të qëlluar, në të vërtetë ai ankohet prej Allahut; atij, që përulet përpara të pasurit (për shkak të pasurisë së tij), do t'i zhduket dy e treta e fesë; ata që do të shkojnë në xhehenem prej kësaj bashkësie (Ummet), janë ata që i kanë nënçmuar dhe që kanë luajtur me argumentet e Allahut.

O Ali, katër gjëra sjellin katër të tjera: Ai që e arrin pushtetin e luksit, bëhet diktator; ai që nuk konsultohet, do të pendohet; si sillësh ndaj të tjerëve, ashtu do të sillen ndaj teje; varfëria është vdekja më e madhe. E pyetën: "A ka të bëjë varfëria me mospasjen e parasë dhe të mallit?" - Ai u përgjigj: "Jo, ka të bëjë me mospasjen e fesë".

O Ali, në ditën e Kiametit do të lotojnë sytë e çdonjërit përveç tre prej tyre: Syri që ishte i zgjuar gjatë natës në rrugën e Allahut; syri që nuk i ka shikuar gjërat e ndaluara dhe syri që ka qarë prej frikës nga Allahu.

O Ali, gënjeshtria lejohet në tri raste: Gjatë luftës, për të mashtruar armikun; gjatë pajtimit dhe përmirë-

simit të marrëdhënieve në mes të dy personave; dhe, dhënia fjalë gruas për blerjen e ndonjë gjësendi (duke e ditur se nuk ke mundësi për ta blerë atë gjësend).

O Ali, të folurit e drejtë nuk është e preferuar në tri raste: Duke folur fjalë të panevojshme, të treguarit një burri në lidhje me gjërat e palakmueshme për familjen e tij; dhe ta kundërshtosh ndokënd që është duke folur të pavërteta por qëllimi i të cilit janë punët e mbara të shoqërisë (këtu kemi të bëjmë me të pavërtetat që nuk i bëjnë dëm popullit, por që janë në të mirën e tyre).

O Ali, katër gjëra janë të kota: Ngrënia pas ngopjes; ndezja e qiriut nën dritën e hënës; mbjellja e farës në tokën shterpe; të bërit mirë ndokujt që nuk është i denjë për atë mirësi.

O Ali, katër persona do ta shijojnë dënimin më shpejt se të tjerët: Atij që ia bën një të mirë, ndërsa ai ta kthen me të keqen; ai që të bën ty padrejtësi, pa ia bërë ti atij më parë; ai që e prish një marrëveshje të pari, pa e prishur ti atë më parë; dhe ai që e ndërpret bamirësinë ndaj të afërmeve, duke mos i ndërprerë ti ato të pari.

O Ali, është e përkryer feja e atij që i zotëron këto katër gjëra: Drejtësinë, falënderimin, turpin dhe moralin e bukur.

O Ali, të hapurit e dorës sa më pak ndaj popullit i paraprin pasurimit, ndërsa hapja e shpeshtë e dorës ndaj popullit është poshtërim. Dhe, kjo është paraprirje për në varfëri.

Marrë nga Libri “ Dhuratë Mendjeve”



SEAN (SILVES SEAL ALI STON

“- Unë jam një çiftut-krishter-musliman, unë dua që njerëzit të kuptojnë të tre fetë, dhe pastaj, këta njerëz të krijojnë një dialog i cili përfshin të gjitha nivelet dhe të kuptojnë dhe të thonë se ne nuk duhet të luftojmë njëri-tjetrin në bazë të diferencave tona, por të bashkohemi në sajë të përbashkëtave tona. Ky është qëllimi im.”

Në shkurt të vitit 2012, mediat amerikane u fokusuan në një lajm që habiti shumë njerëz të klasave të ndryshme. Kjo ndodhi si shkak i konvertimit në fenë Islame, të regjisorit, direktorit dhe aktorit Sean Stone. Menjëherë pas dëshmisë (deklarimit të shehadetit), Sean pohon se ai e ka pranuar Muhammedin si Profetin e fundit, gjatë një interviste në kanalin e shquar amerikan ‘CNN’.

-Por, kush në të vertetë është Sean - Ali Stone?

Sean Stone lindi në qytetin e Nju Jorkut, më 29 dhjetor të vitit 1984. Ishte i biri i parë i një prej regjisorëve me të famshëm të kohës së vet, Oliver Stone, si dhe gruas së tij të dytë Elizabeth Burkit Cox. Babai i tij, Oliver Stone ishte një regjisor çiftut që kishte arritur shumë në karrierën e tij, ndërsa nëna e Seanit, Elizabeta ishte e krishterë dhe punonte si asistente në industrinë e filmave. Dinamika në kulturë dhe në religjion në familjen e Stonëve, ndikoi që Seani të rritet në një ambient mjaft frytdhënës dhe të larmishëm në bindje fetare.

Që në moshë të re mori pjesë në filmat e babait të tij, ku shfaqti talent si dhe interes sa i përket aktrimit si dhe filmografisë. Në vitin 2005, në moshën 21 vjeçare, mori hapin e madh në karrierë, dhe luajti rol si regjisor, direktor si dhe producent në filmin e tij të parë, të titulluar “Duke luftuar kundër kohës: Aleksandri”. Kjo shënon edhe kohën kur Sean fillon të merret më shumë me karrierën e tij si regjisor.

Seani, i krishter me origjinë fetare, në vitin 2012 u

konvertua në Islam, duke pranuar Profetin Muhammed si Profetin e fundit. Dy ditë më vonë, në media u plasua lajmi në të cilin thoshte se:

I biri i Oliver Stone, regjisorit dhe laureatit të çmimit Oskar, u konvertua në Islam në një ceremoni në Republikën Islamike të Iranit, raporton një agjenci e lajmeve.

Sean Stone, u bë musliman në qytetin e bukur Isfahan dhe zgjodhi emrin islam Ali, kështu raportoi agjencia e lajmeve ‘Fars’.

“Konvertimi në Islam nuk më është dukur se unë braktisja Krishterizmin apo Judaizmit, me të cilat kam lindur dhe jam rritur” -tha Stone për agjencinë Fars. “Kjo nënkupton që unë e pranova Muhamedin dhe Profetët e tjerë, dhe tani jamë musliman”

-Cila është ideologjia e tij?

Në një intervistë për kanalin televiziv amerikan ‘CNN’, Sean shpreh mendimin se, për tu stabilizuar



STER) STONE



“Islami nuk është vetëm një dogmë apo princip se si duhet të vishemi, lahemi, ushqehemi, falemi e tjera, por të krijojmë një marrëdhënie ne mes Zotit dhe njeriut duke qëndruar para Tij, duke qenë i zoti ti thuash vetes, se unë kam një shëmbëlltyrë një figurë siç është ajo e Imam Husejnit që unë e zgjodha për vete.”

situata në lindjen e mesme midis shteteve Islamike dhe shtetit të Israelit, por edhe për tu stabilizuar situata e përgjithshme e marrëdhënieve midis feve të ndryshme, e madje edhe përçarjeve brenda fesë, duhet të fillojnë dialogjet midis të gjitha palëve, dhe se dialogu është qasja e vetme e cila mund të sjell ekuilibrim dhe balancim sa i përket marrëdhënieve me karakter fetar. Ai gjithashtu shton se:

“- Unë jam një Çifut-krishter-musliman, unë dua që njerëzit të kuptojnë të tre fetët, dhe pastaj, këta njerëz të krijojnë një dialog i cili përfshin të gjitha nivelet dhe të kuptojnë dhe të thonë se ne nuk duhet të luftojmë njëri-tjetrin në bazë të diferencave tona, por të bashkoemi në sajë të përbashkëtave tona. Ky është qëllimi im

Sean tregon respekt të madh për shtetin e Iranit, si dhe për administrimin shtetëror. Seani deklaroi haptazi se e përkrah qasjen sa i përket politikës së

jashtme dhe armëve bërthamore, temë për të cilën është kritikuar disa herë në intervista. Në një intervistë për emisionin “O'Reilly Factor”, Stone shpreh mendimin se problemi i marrëdhënieve midis Iranit dhe shteteve të tjera, është qasja imperialiste e shteteve perëndimore.

Cili është kontributi i tij në sferën Islamike si dhe në bote?

Sean luan në mbi 15 filma, shumica me regji të Oliver Stone, ndërsa të tjerat nga vet Sean. Më të famshmet nga këto filma janë “Salvador(1986)”, “Eall Street(1987)” si dhe “JFK(1981)”.

Sean është gjithashtu autor si dhe direktor i gjithsej 7 filmave me përmbajtje të ndryshme, dy prej të cilave janë të prodhuara nga vetë ai. Më i famshi ndër filmat e tij njihet si “Guri ngjyrë hiri (Graystone)”, i cili flet për eksperiencën paranormale të bazuara në eksperiencën personale të vet Seanit, gjatë një ekspedite në një spital psikiatrik

Gjithashtu, Stone është pjesëtar i Bordit të Këshilltarëve për kompaninë “MindShare Ventures Group” me qendër në Nju Jork. Kompania është e përfshirë në disa fusha të biznesit, duke përfshirë argëtimin, komoditetet, kujdesin shëndetësor, pasurive të patundshme, të teknologjisë dhe të kapitaleve. Ai ishte i ftuar për tu bërë pjesë e Bordit në vitin 2013 nga themeluesi dhe kryetari i kompanisë, Ali Naqvi.

Për momentin Sean është duke punuar për realizimin e një dokumentarit shëndetësor që fokusohet tek xhinnët, krijesa mbinatyrore në Islam, të

cilën pret ta përfundoj në fund të këtij viti.

-Cili është kontributi i tij në sferën Islamike si dhe në botë?

Sean është autor si dhe direktor i disa filmave me përmbajtje të ndryshme, më i famshi ndër ta njihet si “Guri ngjyrë hiri (Graystone)”, i cili flet për eksperiencën paranormale të bazuar në eksperiencën personale.

Ndërsa sa i përket kontributit të tij në sferën islamike kulturore është se ai vetëdijëson shumë të rinjë me autoritetin dhe bindjen e tij të re pra kthimin në islam.

Si e përqafova fenë Islame – Pse e pranova Profetin Muhamed .

Problemin që e kam parë në shumë vende në botë është mënyra në të cilën njerëzit e fusin veten në kategori të ndryshme të stereotipave dhe kështu e përcaktojnë se kjo është mirë apo keq për mua. Njerëzit janë krijesa të llojllojshme në raca, gji-ni, kombe e kombësi dhe kjo është një begati për njerëzinë ngase në këtë mënyrë ne e adhurojmë Allahun duke falënderuar për këtë mrekulli në krijim, që mund ta bëjë vetëm Ai.

Unë e pranova Muhamedin (paqa qoftë mbi të dhe Familjen e tij) si Dërguar i fundit i Zotit, e dashurova Imam Aliun, Ashuran, Imam Husejnin, kam respekt të veçantë për këto personalitete. Kur isha pjesëmarrës në një tubim të ashures (tubim solidarizimi për përkujtimin e ndodhisë së Qerbelasë), duke i dëgjuar ato poezi me melodi dhe fjalë që buroni nga zemra të plagosura dhe laheshin me lot, për një të vërtetë që kishte ndodhur para 1400 viteve. Kjo mua më dha një ndjenjë nderi që isha në mesin e tyre për të përkujtuar një njeri kaq të madh si Imam Husejni për të cilin unë atëherë kisha shumë pak njohuri. Kjo ndjenjë dhe ky çast ishte një shkëndijë nga Zoti në shpirtin tim, që më bëri të kuptoj se sakrifica dhe ngritja e të shtypurve kundër tiranisë, kundër një perandorie të madhe mizore, më bëri të kuptoj pretendimin shumë fisnik dhe dinjitoz të Imamatit dhe ky tubim përkujtimi dhe solidarizimi Ashura, ishte një udhëzim për mua, se kjo ndodhi e Qerbelas, nuk është vetëm një ngjarje historike, që ka pas vlerë në të kaluarën, por pjesëmarrësit e Ashuras tregojnë vlerat e sakrificës së Imam Husejnit edhe në të sotmen dhe në të ardhmen gjersa të ekzistojë koha. Manifestimi i Ashuras na jep fisnikëri, nder dhe solidarizim pa marrë parasysh se a jemi musliman, të

krishterë apo hebrej. Prandaj tragjedia e Qerbelas u bë simbol i vetëdijesimit për të Drejtën të Vërtetën në gjithë botën dhe për të gjithë kohërat. Këtu ndonjë foto të ashures, dhe nxjerre si tekst në vetë por mos del prej paragrafëve

Islamin e kuptova si një përlulesi, nënshtrim ndaj Zotit, Islami ka një forcë të mahnitshme që të shtynë të besosh, që në këtë forcë do të duhet të mbjellim në vetë si dhe nuk mjafton të thuash vetëm unë jam musliman, Islami nuk është vetëm një dogmë apo princip se si duhet të vishemi, lahemi, ushqehemi, falemi e tjera, por të krijojmë një marrëdhënie në mes Zotit dhe njeriut duke qëndruar para Tij, duke qenë i zoti të thuash vetes, se unë kam një shembëlltë të një figure siç është ajo e Imam Husejnit që unë e zgjodha për vetë.

Ky shebull i Imam Husejnit që sakrifikoji veten jo si agresor por duke qenë i shtypur së bashku me shoqërinë, tregon dhe vetëdijëson shumë njerëz të mençur se ai me familjen dhe shokët e tij, e zgjodhi të Drejtën, të Vërtetën që ia mësoi gjyshi i tij Muhamedi s.a.a. dhe vendosi të sakrifikojë jetën, pasurinë dhe familjen e tij për këtë ideal pra për Islamin. Kjo pra, është një fe, një moral një Islam që ne duhet të ndjekim, kjo është natyra e Islamit tek unë dhe unë do të shtegtojë në këtë rrugë të Imam Husejnit paqa qoftë mbi të.

Përktheu dhe përshtati: Gent Reshtani





Planet e Muaviut

Mbas luftës së Sifninit dhe çështjes së pajtimit Muaviu filloi të vepronte sikur të ishte udhëheqësi suprem. Ai filloi të mbledhte zeqatet dhe haraçet (taksat), dërgoi ushtri nëpër krahina për të fikësuar njerëzit dhe të shtrijë sundimin e tij në zona të ndryshme. Ai zgjodhi si drejtues të ushtrive të tij një grup personash kriminelë të cilët nuk e njihni Islamin por ishin prej atyre që mbanin urrejte dhe armiqësi për islamin. Muaviu i mësoi atyre mësimet terroriste në kundërshtim me ato që porosiste Profeti Muhamedi(s.a.s) ushtritë e tij.

Muaviu e urdhëroi Sufjanë ibën Auf El – Gamidij të hyjë në Irak dhe e porosi atë që të vjedhi, të djegi të vrasi duke i thënë: «Shkatarro çdo gjë prej atyre që të dalin përballë dhe vrit çdo person që takon i cili nuk është prej flamurit tënd, merri pasuritë sepse ajo është e ngjashme me luftën, dhe

ky veprim është më i dhimbshëm dhe më i tmershëm për zemrat».

Sufjani i praktikoi këshillat e Muaviut dhe shtoi mbi to sepse sulmoi Ehli Dhimin (pronaret e Dhimit) dhe i vrau e i vodhi ato. Muaviu e dërgoi Dah-hak ibën Kajs El – Fehri së bashku me tremijë apo katër mijë ushtarë në drejtim të Kufes dhe prej këshillave të tij për të ishte:

«... Ato që do të gjesh prej atyre që i përluan Aliut(a.s) vriti...». Dah – hak nuk i theu këshillat e zontisë së tij. Ai vrau çdo njeri që takonte dhe i merrte paratë, derisa mbërriti në fshatin Tha'lebe (ky është një fshat që ndodhet në rrugën e Mekes). Ai sulmoi kur-

vanet e haxhijve dhe i mori bagazhet dhe vrau një grup prej tyre.

Po ashtu Muaviu dërgoi Biser ibën Ebu Erta'ta drejtues të ushtrisë e përbërë prej tre mijë ushtarësh dhe e drejtoi atë kah Jemeni: Muaviu e porosi atë duke i thënë: **«Përzei njerëzit dhe frikësoje atë që kalon pranë tij, merri pasuritë e atyre që e din se janë të pastër dhe nuk zbaton urdhërat tona.. dhe vriti dashamirësit e Aliut(a.s) kudo që janë».** Ai filloi të kërkoi për ato që e donin Aliun (a.s) dhe e kundërshtuan t'ja japin betimin Muaviut. Ai dogji shtëpitë e tyre dhe grabiti pasuritë e tyre. Besiri sulmoi Hamdanin ku vrau dhe robëroi femrat e tyre. Ato ishin të parat myslimane të cilat u robëruan në islam dhe u çuan nëpër tregje. Prej tij nuk shpëtuan as fëmijët.

Kur shkoi në Jemen, kryetar i Jemenit ishte Ubejdullah ibën Abas halife (mëkëmbës) i caktuar nga Aliu paqja qoftë mbi të. Ai iku nga Jemeni dhe shkoi në Kufe tek Imam Aliu (a.s). Në vend të tij Imam Aliu – paqja qoftë mbi të, caktoi Abdullah ibën Harithin. Besiri shkoi tek ai dhe e vrau atë së bashku me djalin e tij. Po ashtu ai i rrëmbeu dy djemtë e Ubejdullah ibën Abas dhe i vrau ata. Këto dy fëmijë banonin tek një burrë prej Kenanit në Badijeh. Kur Besiri dëshiti ti vriste dy fëmijët ai burri i tha: **“ Përse don ti vrasësh këto dy? Ata nuk kanë asnjë faj. Nëse don ti vrasësh ato më vrit mua me ata.”** Besiri i vrau të dy fëmijët së bashku me mbikëqyrësin e tyre. Gratë e fisit Kenan dolën dhe njëra prej tyre tha: O ti, vrave të mëdhenjtë dhe përse i vret të vegjlit? Pasha Zotin këto nuk vriteshin as në kohën para Islamit dhe as në Islam. Pasha Zotin O i biri i Erta'ta, ai mbret i cili nuk vepron vetëm se vret të vegjlit, të moshuarit, dhe ndan në mes të afërmëve, ai është mbret i padrejtë. Ndërsa nëna e dy djemve të therë ajo vdiq mbasi e goditi një krizë në tru.


Kur Imam Aliu (as) dëgjoi për vrasjen e dy fëmijëve u pikëllua shumë dhe bëri lutje mbi Basirin. Duke thënë: **“O Zot, zhvishe prej fesë, dhe mendjes.”**

Kjo lutje e Imam Aliut(a.s) u plotësua. Ai u çmend dhe vazhdoi kështu derisa vdiq.

Këto janë disa shembuj prej jetës së Muaviut dhe të ndjekësve të tij. Muaviu i përkufizoi qëllimet e tij në luftëra në hytben që mbajti për banorët e Kufes mbas pajtimit me imam Hasanin (as) ku tha:

“Pasha Zotin, unë nuk ju luftoj juve që të faleni, të agjëroni, të jepni zeqat, të shkoni në haxh, sepse ju i veproni ato, por unë ju luftoj që të jem sunduesi i juaj».

Kjo ishte jeta e Muaviut dhe përballë tij ndodhej Imam Ali-



Shehadeti Imam Aliut

u(a.s) i cili i porosiste nëpunësit dhe udhëheqësit e ushtrive të cilët i dërgonte për tu mbrojt prej sulmeve:

“Frikësohuni Zotit në ato vende ku do shkoni, mos grabitni pasuritë, as fëmije, as gjenezat... Dhe faleni namazin në kohën e caktuar».

Ai i porosiste për respektim të njerëzve qofshin myslimanë apo jo myslimanë.

Prandaj konflikti i Aliut (a.s) me Muaviun ka qenë konflikt i dy vijave: vijës së

drejtësisë dhe parimeve të vlerave morale dhe vijës së devijimit, humbjes dhe

mashtimit. Është e pamundur që këto dy vija të bashkohen. Për këtë, Imam Aliu gjithmonë ka

qenë i vendosur në luftimin e padrejtësisë sado që të ishin pasojat.

- Dita e 19 e Ramazanit tronditi besimtarin -


Në rahmetin e Zotit

Imam Aliu paqja qoftë mbi të, i dha fund rezistencës së marikineve dhe u përgatit për të luftuar kasitinët në Sham (Muaviun dhe ndjekësit e tij). Mbasi pajtimi u bë i pavlefshëm në bashkimin midis dy ligjeve Imam Aliu (as) urdhëroi që ushtria të përgatitet dhe informoi për luftë me qëllim që të zhdukte fuqitë e kasitinëve në Sham të cilët i udhëhiqte Muaviu. Ai i dha një batalion Husejnit, një Ebi Ejub Ensarit, dhe të tretin, Kajs ibën Sa'dit. Në kohën që imam Aliu po përgatiste ushtrinë, në fshehtësi po bëhesin planet e poshtra për të vrarë Imamin (as). Një grup armiqsh u mbledhën në Meke dhe vendosën që të vrasin Imam Aliun (as). Në kohën kur ymeti mysliman po shkonte drejt fitores mbi të padrejtët të cilët i drejtonte Muaviu, dora e mëkatarit El -Muradij goditi

imam Aliun (as) dhe ai ndodhej në sexhde në namazin e sabahut në xhaminë e Kufes së bekuar. Kjo ndodhi në mëngjesin e ditës së nëntëmbëdhjetë të muajit Ramazan në vitin 40 të hixhrit.

Imam Aliu (as) u vra në kohën më të përsosur ku ndodhej në mes duarve të Allahut në namaz.

Në ditët më të bekuar sepse ishte muaji Ramazan. Po ashtu ndodhej në vendin më të ndershëm dhe më të pastër (xhamia e Kufes). Në kohën kur ymeti mysliman po shkonte drejt fitores mbi të padrejtët të cilët i drejtonte Muaviu, dora e mëkatarit El -Muradij goditi imam Aliun (as) dhe ai ndodhej në sexhde në namazin e sabahut në xhaminë e Kufes së bekuar. Kjo ndodhi në mëngjesin e ditës së nëntëmbëdhjetë të muajit Ramazan në vitin 40 të hixhrit.



Ky krim nuk vrau një person si të gjithë personat, por ai vrau drejtuesin e islamit mbas Profet Muhamedit s.a.a.a.. Ai vrau mesazhin, historinë, qytetërimin, ymetin, të gjitha këto ishin të bashkëngjitura në personalitetin e imam Aliut (as). Me këtë krim të ndytë meti mysliman humbi orientimin dhe qytetërimin, po ashtu ai humbi periudhat më të përsosura dhe më të pastra të jetës së tij pas Profetit Muhamedit s.a.a.

Pjesë e marrë nga Libri : “Përmbledhje e jetës së Profetit dhe Ehli Bejtit “– përktheu nga gjuha arabe , Vullnet Merja.

LETËRSIA E BEJTENXHIVE



Në shekullin XVIII në Shqipëri lindi dhe u zhvillua një rrymë letrare me tipare tepër origjinale për vendin tonë e njohur si rryma e bejtexhinjve (nga fjala turke “bejte” - vjershë). Ajo u bë dukuri e rëndësishme dhe pati përhapje shumë të gjerë në qytete të ndryshme të Shqipërisë, në Kosovë, por edhe në qendra më të vogla fetare e më pak në fshatra. Rryma letrare e bejtexhinjve ishte produkt i disa kushteve të veçanta historike, i dy palë faktorëve të kundërt.

Nga njëra anë ishte kërkesa për të shkruar shqipen si gjuhën e vendit, për ta përdorur edhe në praktikën fetare e për t’u çliruar nga ndikimet e kulturave të huaja. Kjo ishte më tepër prirje e shtresave që lidheshin me format e reja ekonomike, (tregtare e monetare). Nga ana tjetër, është shtimi i trysnisë ideologjike të pushtuesit . nga ana tjetër nëpërmjet fesë dhe kulturës Islame synohej të arrihej nënshtrimi i shqiptarëve. Pushtuesi hapi këtu edhe shkollat e veta. Shumë poetë bejtexhinj ishin mësuar në to.

Natyrisht, krijimtaria poetike e bejtexhinjve ruan ndikimin e poezisë e të kulturës orientale, por ajo është pjesë e pandarë e kulturës së popullit tonë. Ajo është shprehje e talentit, e shpirtit krijues të tij, që, në kushte të caktuara, fitoi edhe tipare në përputhje me to. Bejtexhinjtë e shkruan shqipen me alfabet arab dhe përdorën një gjuhë të mbushur nga fjalët persiane, turke e arabe.

Letërsia e bejtexhinjve pati dy faza në zhvillimin e saj. Faza e parë shkon gjer nga fundi i shekullit XVIII. Në veprat e kësaj faze më tepër gjeti shprehje fryma laike, kurse në veprat e fazës së dytë, që nis nga çereku i fundit i shekullit XVIII dhe kapërcen në shekullin e XIX, mbi-

zotëroi tema me karakter fetar. Në krijimet me tema laike mjaft poetë bejtexhinj, në frymën e poezive orientale, i kënduan dashurisë, bukurisë së natyrës e të gruas, lartësuan virtytin, punën, diturinë ose fshikulluan mburrjen e kotë për pasurinë e fisin, goditën ambicjen, hipokrizinë etj. Të tillë ishin Nezim Frakulla, Sulejman Naibi, Muhamet Kyçyku etj.

Një hap i mëtejshëm u shënua me mjaft krijime të disa bejtexhinjve të tjerë, si: Hasan Zyko Kamberi, Zenel Bastari e ndonjë tjetër. Ata pasqyruan elemente e ngjarje të jetës bashkohore dhe shtruan një problematikë të mprehtë shoqërore. Me nota realiste, ata vunë në dukje jetën e vështirë plot vuajtje të masave të varfra të popullit, pasigurinë për të ardhmen dhe pakënaqësinë e tyre në kushtet e sundimit feudal, në shthurrrje e sipër.

Megjithatë, bejtexhinjtë me krijimet e tyre dhanë një ndihmesë që duhet çmuar. Ata shkruan shqip në një kohë kur shqipen e kërcënonte rreziku nga përhapja e gjuhës së pushtuesit dhe e gjuhëve të tjera. Ata krahas temës fetare, ishin të parët që trajtuan gjerësisht temën laike. Gjithashtu disa prej tyre duke qenë më afër jetës së popullit, futën në poezi elementë të jetës së kohës.

Këta trajtuan tematikën shoqërore me nota realiste dhe me një sens kritik të fortë. Një ndër këta autorë është edhe Naim Frashëri i cili lidh idealin i shqiptarizmit, me bektashizmin.

Shqipëria është një ndër vendet e pakta në Ballkan ku populli është i njohur me Qerbelanë dhe Ehli Bejtin e Profetit(s.a.a). Për to kanë shkruar shumë shkrimtarë shqiptarë, veprat e të cilëve janë trashëguar brez pas brezi deri më sot. Një prej këtyre shkrimtarëve është

edhe Naim Frashëri i cili në veprat e tij ka folur për ngjarjen e Qerbelasë dhe për Ehli Bejtin e Profetit(s.a.a). Naim Frashëri është poeti i cili lidh idealin i shqiptarizmit, me bektashizmin, që i hartoi për afrimin e elementit besimtar në lëvizjen kombëtare.

NAIM FRASHËRI DHE ROLI I TIJ NDIKUES NË SHOQËRI

Figura qendrore e letërsisë shqiptare të Rilindjes, ai që u bë shprehës i aspiratave të popullit për liri e përparim, si poet i madh i kombit, është Naim Frashëri, bilbili i gjuhës shqipe.

Naim Frashëri vuri themelet e letërsisë kombëtare shqiptare. Vepra e tij shënoi lindjen e një letërsie të re me vlera të vërteta artistike. Ajo shprehte aspiratat e shoqërisë shqiptare të kohës dhe ndikoi fuqishëm në luftën e saj për liri e progres. Dashuria për Atdheun, popullin dhe njeriun, krenaria kombëtare dhe besimi në të ardhmen, ideja e madhe e çlirimit, formojnë thelbin romantik të veprës së tij. Naimi e afroi letërsinë me popullin, duke trajtuar tema të reja, të ndryshme nga ato të letërsisë së vjetër, temat e problemet e kohës. Në formimin e Naim-it si poet ndikuan disa faktorë, por faktori kryesor ishte jeta e popullit të vet dhe lëvizja e tij për çlirim kombëtar. Naimi është bilbili i gjuhës shqipe, mjeshtër i fjalës. Vepra e tij vuri bazat e gjuhës letrare kombëtare shqipe, e cila do të njihte më vonë një zhvillim të mëtejshëm, për të arritur gjer në shqipen e sotme letrare kombëtare të njësuar e të zhvilluar. Tradita që krijoi Naimi, është e gjallë dhe frymëzuese edhe në jetën e shoqërisë sonë të sotme

Naim Frashëri në letërsinë e bejtxhinjëve njihet me poemën tij "Qerbelaja". Kjo poemë epike është krahasuar me "Iladën" shiite, ku tregon për konfliktin sunit-shiit,

që u krijua brenda Islamit pas vdekjes së Muhamedit, kjo për shkak të rivalitetit për postin e kalifit, kreut të religjionit e të shtetit islam.


Tek "Qerbelaja" Naim Frashëri, përshkruan të gjitha betejat e asaj kohe midis shiitëve dhe sunitëve, duke i paraqitur të parët si engjëj ndërsa të dytët si djaj: «Më një an' ish imam Hyseni/Më an' tjetër Jezit qeni/

Ai u drejtohet shqiptarëve: «Për Hasanë e për Hysenë/Për ju e për mëmëdhenë/t' përpiqi nat' e ditë/Sa të dalëmë në dritë.

Pra, vëllimi poetik Qerbelaja hedh në dritë mbi një tragjedi të madhe njerëzore të shprehur me gjuhën e poezisë, të mbushur me ndjenja shpirtërore e fetare. Vepra e ngriti frymëzon me idealet e lirisë dhe të pavarësisë. Naim Frashëri ngriti në nivelin më të lartë artistik poezinë e letërsinë shqiptare.

Naim Frashëri u bë një veprimtar revolucionar në tërë fushat, si shkrimtar, njeri i mendimit, njeri politik. E gjithë veprimtaria e tij letrare dhe kulturore ishte e lidhur ngushtë me çlirimin dhe përparimin e vendit, me çlirimin shpirtëror dhe ndriçimin e masave të popullit. Ai kishte besim të plotë në aftësinë e mendjes për të njohur realitetin e për të vënë në shërbim të njeriut njohjen e ligjeve të botës. Kërkon shqiptarëve (besën, trimërinë, bujarinë), traditat kombëtare që nga lashtësia pelazgjike. Bënte thirrje për miqësi me fqinjët në kushtet e respektit reciprok, shpallte dashurinë në gjithë popujt e racat, ngrihej me forcë kundër Megali Idesë e pansllavizmit, duke admiruar vetitë dhe kulturën e popujve të tjerë (poezinë përparimtare lindore, atë greke, latine, rilindjen evropiane, romantizmin evropian, prej të cilave dhe u ndikua).

Punoi: Ardian Ismaili





SË SHPEJTI NË KOSOVË DO TË FILLOJË PUNËN INSTITUTI KËRKIMOR NDËRKOMBËTAR ”NAIM FRASHËRI “

Instituti u themelua nga njerëz të shkencës, që kanë vullnet dhe ekspertizë në lëmi të ndryshme shkencore, me synimin për të bërë një punë të rëndësishme në shoqërinë tonë, duke dhënë kontributin e tyre në fusha të ndryshme të shkencës e dijes.

Misioni i IKN “NAIM FRASHËRI ” ka për qëllim të krijojë ura lidhëse ndërmjet njeriut si qenie individuale, në përpjekje për mbijetesë në botën e sotme, duke e plotësuar atë në një qenie humane materiale e shpirtërore në shoqërinë që e rrethon

Instituti ynë do të realizojë misionin e vet në të mirë të njerëzisë, duke u mbështetur në modellet më njerëzore, e një nga to do të jetë modeli i Naim Bej Frashërit.

Vizioni ynë është krijimi i një modeli të shoqërisë civile të karakterizuar nga liria, përgjegjëshmëria, respekti për diversitetin, përpjekjet për drejtësi dhe barazi, zgjimi i pasionit për dinjitetin njerëzor dhe përkushtimi i pareshtur për të mirën e përgjithshme.

Realizimi i misionit të IKN “NAIM FRASHËRI” në radhë të parë do të jetë në Republikën e Kosovës, pastaj në shtetet fqinje, mërgatën e trojeve shqiptare dhe në hapësirat ndërkombëtare.

•Objektivat

1. Ngritja e kodit shoqëror përmes fuqizimit të vlerave, atyre tradicionale, fetare, sociale morale dhe kulturore tek individ dhe më gjerë.
2. Realizimi i misionit të IKN “Naim Frashëri” në radhë të parë do të jetë në Republikën e Kosovës, pastaj në shtetet fqinje, mërgatën e trojeve shqiptare dhe në hapësirat ndërkombëtare.
3. Krijimi i teorive dhe doktrinae përmes humltimeve dhe studimeve historiko-shkencore, me qëllim të vetëdijesimit të popullatës për dobitë e ruajtjes dhe përdorimit të vlerave humane.
4. Dalja nga kaosi i gjendjes aktuale të zbatimit të drejtësisë në shoqërinë europiane duke përdorur logjikën e shëndoshë dhe resurset humane intelektuale.
5. Përkrahja e intelektualëve të fushave të ndryshme që kanë aftësi udhëheqëse dhe shprespëdhënëse duke sjellë ndryshime pozitive në shoqëri.

Mirësia

Mërgohu nga ligësitë,
Mirësin' e mba si burrë;
Mirësija 'shtë në dritë,
Që nuk shuhet kurrë,

Mirësija s'është' e shkretë,
Është drit' e Perëndisë,
Drit' e Zotit e gjithësisë

Mirësija të harrohej,
Të mirët nuk' i donim;
Ligësija të lëvdohej,
Të liqtë s'i mallëkonim.

Përse e duam Alinë?
Edhe të tërë të mirët?
Se duamë mirësinë,
Që s'na fut në errësirët.

Pse e duam Fatimenë?
Imamët të dy-mbë-thetë?
Hasanë edhe Hysenë?
Se ishin të vërtet.

Se kishin mirësinë,
S'patën kurrë ligësitë,
Ishinë me Perëndinë,
Na lanë dhe nevej dritë

Kurrë s'humbet mirësija,
S'suhet drit' e Perëndisë;
Humbet vallë Perëndija?
Zot' i math' i gjithësisë!

Mos' e ndy shpirtin në jetë,
Zëmërenë mos' e lyej;
Shko n' udhëzët të vërtetë,
Mos u kthe e mos' u thyej.

Mos i hiq pas ligësisë,
Se të fut në errësirët;
Mer udhën' e Perëndisë,
Të bashkohesh me të mirët.

Mos bëj keq kurrë, po mirë,
Kjo është' udh' e Perëndisë,
Ki zemërë mëshirë,
Edhe ndihni njerëzisë,

Mos u përzje me Syfjanë,
Mos u bëj me Mavijenë;
Me Jezitin' e me Mervanë,
Po bashkohu ,me Hysenë.

Kur tha kam at' Alinë,
Edhe mëmë Fatimenë;
Qysh' e bëke ligësinë?
Që të pjek me Mavijenë!

Naim Frashëri

VEPRAT DHE LUTJET E VEÇANTA GJATË MUAJIT

Ramazan

NATA E PARË E HYRJES NË RAMAZAN:

- a) Përpjekje për shikimin e hënës së Ramazanit. Disa dijetarë (teologë) e kanë bërë të obligueshme këtë çështje.
- b) Gusli (larja).
- c) Katër rekate namaz ku lexohet:
Surja El Fatiha dhe surja El Ihlas 20 herë (d.m.th. në një rekat surja El Ihlas lexohet nga 5 herë.)
- d) Të lexohet sa më shumë Kur'ani
- e) Leximi i lutjeve të llojllojshme që i keni në këtë libër.

DITA E PARË

Në këtë ditë kryen këto veprime:

- 1-Gusli (larja) deri para syfyrit të parë
- 2-Dhënia e sadakasë (bimirësisë për varfanjakë e jetimë) gjatë kësaj dite.

Lutja (pas syfyrit të parë)

“O Zot: Bëje agjërimin tim në këtë muaj si ai i agjëruessve të vërtetë; dhe namazin tim në këtë muaj si ai i falësve të sinqertë; dhe më zgjo prej gjumit të pavëmendshëm; dhe fali mëkatet e mia në këtë muaj, O Zot i botëve, O Falës i mëkateve dhe i kriminelëve. O Zot!”

NATA E PARË

Falen katër rekate namaz, në çdo rekat lexohet një herë surja El Fatiha dhe 15 herë surja El Ihlas.

DITA E DYTË

Lutja

“O Zot: Më afro në këtë muaj tek begatitë e Tua dhe më largo në këtë muaj prej zemërimeve dhe hakmarrjeve të Tua. Më mbarëso në këtë muaj që të lexoj ajetet (versetet) e Kur'anit Tënd. Me mëshirën Tëndë o Mëshirues, o Mëshirëbërës! O Zot i Madh!”

NATA E DYTË

Falen katër rekate namaz. Në çdo rekat lexohet surja El Fatiha dhe 20 herë surja El Kadër (në çdo rekat lexohet nga 5 herë surja el Kadër).

DITA E TRETË

Lutja

“O Zot: Më dhuro në këtë muaj mendim dhe paralajmërim; dhe më largo prej marrëzive dhe moskuptimit; dhe më cakto pjesë prej të mirave të Tua, të cilat i zbrite në këtë muaj, me Bujarinë Tëndë, O Dhënës, O Bujar, O Zot i Madh”.

NATA E TRETË

Falen dhjetë rekate namaz dhe lexohet surja El Fatiha dhe surja El Ihlas 50 herë, (d.m.th. në çdo rekat lexohet nga pesë herë surja El Ihlas).

DITA E KATËRT

Lutja

“O Zot: Më jep fuqi në këtë muaj që t'i kryej obligimet e Tua. Më provo në këtë muaj ëmbëlsirën e dhikrit Tënd dhe më veço mua në këtë muaj që të të falënderoj Ty për dhënitë e Tua të shumta. Më mbro me mbrojtjen Tëndë dhe me mbulimin Tënd, o Shikues, o Zot i Madh!”

NATA E KATËRT

Falen tetë rekate namaz. Në çdo rekat lexohet surja El Fatiha dhe surja El Kadër 20 herë. (d.m.th. në 4 rekatë surja El Kadër lexohet nga 3 herë, kurse në 4 rekatë lexohet nga 2 herë. Pra, gjithsej, surja El Kadër lexohet 20 herë).

DITA E PESTË

Lutja

“O Zot: Më bëj në këtë muaj prej të penduarave; dhe më bëj prej adhuruesve të Tu të pëlqyeshëm; dhe më bëj në këtë muaj prej evliave të Tu të afrueshëm tek Ti, me Mëshirën Tënde O Mëshirues, O Mëshirëbërës, O Zot i Madh!”

NATA E PESTË

Falen dy rekate namaz dhe lexohet surja El Fatiha dhe surja El Ihlas 50 herë, (d.m.th. në çdo rekat surja Ihlas lexohet nga 25 herë).

Mbas namazit dërgohen 100 herë salavate mbi Pejgamberin dhe mbi familjen e Muhamedit (s.a.a)

ALLAHUM-ME SAL-LI A'LA MUHAM-MED VE ALIHI MUHAM-MED

DITA E GJASHTË

Lutja

“O Zot: Mos më poshtëro në këtë muaj dhe mos më dëno me kamxhikët e hakmarrjes Tënde. Më largo prej zemërimeve të Tua, për hir të dhënies Tënde të shijshme, o Plotësues i dëshirave të dëshirueseve, o Zot i Madh!”

NATA E GJASHTË

Falen katër rekate dhe lexohet surja El Fatiha dhe surja El Mulk. Si kjo ditë, pra me 6-të Ramazan të vitit 201 të Hixhrit, u bë betimi i Imam Ridhait (Allahu qoftë i kënaqur me të). Në këtë natë është mustehab (e pëlqyeshme) të falen dy rekate namaz falënderimi, ku lexohet surja El Hamd dhe surja El Ihlas 25 herë. (Në njërin rekat, surja El Ihlas (apo siç e njih populli Kulhuvallahi) lexohet 10 herë, kurse në tjetrin lexohet 15 herë.)

DITA E SHTATË

Lutja

“O Zot: Më ndihmo në agjërimin e Ramazanit, më ndihmo që të fal namazet në Ramazan, më largo prej gabimeve dhe mëkatëve dhe më mbarëso në këtë muaj me dhikrin Tënd gjatë gjithë kohës së Ramazanit, o Mbarësues, o Orientues i të humburve, O Zot i Madh!”



NATA E SHTATË

Falen katër rekate namaz dhe lexohet surja El Hamd (Fatihaja) dhe surja El Kadër 13 herë. (ndajini sipas dëshirës)

DITA E TETË

Lutja

“O Zot. Mbille tek unë mëshirën ndaj jetimëve në këtë muaj dhe shumëfishoje furnizimin e të uriturve, përhapjen e paqes dhe shoqërimin e bamirëseve, për hir të pafundësisë Tënde, o Strehues i të strehuarve, o Zot i Madh!”

NATA E TETË

Falen dy rekate namaz ku lexohet surja El Fatiha dhe surja El Ihlas 10 herë. (Në çdo rekat lexohet nga 5 herë).

Mbas namazit thuhet njëmijë (1000) Subhanallah (I Lartësuar je o Allah).

DITA E NËNTË

Lutja

“O Zot: Më cakto mua një pjesë të Mëshirës Tënde në këtë muaj. Më oriento me argumentet e Tua të ndershme dhe më tërhiq mua në dashurinë Tënde. O i Dashur, për hak të Dashurive të Tua. O Shpresa e mallëngjyeseve të Tu, O Zot i Madh!”

NATA E NËNTË

Në këtë natë falen gjashtë rekate namaz, në mes të namazit të akshamit (magrib) dhe namazit të jacisë (Ishasë). Në çdo rekat lexohet një herë surja El Fatiha dhe gjashtë herë Ajetul Kursija. Mbas namazit thuhet 50 herë salavatet mbi Muhamedin (s.a.a.) dhe familjen e Tij të pastër (a.s).

DITA E DHJETË

Lutja

“O Zot: Më bëj mua në këtë muaj prej mbështetësve të Tu dhe më bëj mua prej afruesve të Tu, për hak të Mirësive të Tua, o Plotësues i dëshirave të kërkueseve, o Zot i Madh!”

NATA E DHJETË

Në këtë natë falen 20 rekate namaz, ku lexohet surja El Fatiha dhe surja El Ihlas 30-të herë. (ndaji sipas dëshirës)

DITA E NJËMBËDHJETË

Lutja

“O Zot: M’i bëj të pëlqyeshme të mirat në këtë muaj dhe m’i bëj të papëlqyeshme kundërshtimet dhe të këqijat e mia në këtë muaj. Më mbroj nga zemërimi dhe zjarri Yt, me mbrojtjen Tënde, o Strehues, o Ndihmues, o Zot i Madh!”

NATA E NJËMBËDHJETË

Në këtë natë falen dy rekate namaz, ku lexohet një herë surja El Fatiha dhe njëzet 20 herë surja El Keuther. (ndaji sipas dëshirës)

DITA E DYMBËDHJETË

Lutja

“O Zot: Më zbukuro në këtë muaj duke m’i mbuluar të këqijat dhe duke më nderuar. Më mbulo në këtë muaj me rrobat e bindjes dhe të barazisë dhe më ruaj nga padrejtësia, dhe më mbro prej atij që i frikësohem, me mbrojtjen Tënde, O Mbrojtës i të frikësuarve, o Zot i Madh!”

NATA E DYMBËDHJETË

Në këtë natë falen tetë (8) rekate namaz, ku lexohet surja El Fatiha dhe 30 herë surja El Kadër.

DITA E TREMBËDHJETË

Lutja

“O Zot! Më pastro në këtë muaj prej ndyrësive dhe më bëj të durueshëm ndaj detyrave dhe obligimeve të të tjerëve. Më mbarëso në këtë muaj duke u mbështetur tek Ti dhe duke u shoqëruar me të mirët me mbrojtjen Tënde, o Drita e syve të të mjerëve, o Zot i madh!”

NATA E TREMBËDHJETË

Në këtë natë falen katër rekate namaz, ku lexohet surja El Fatiha dhe njëzet herë surja El Ihlas.

DITA E KATËRMBËDHJETË

Lutja

“O Zot: Mos më dëno për shkak të mëkateve të mia në këtë muaj dhe m’i pakëso gabimet dhe fajet e mia në këtë muaj. Mos më ballafaqo në këtë muaj me fatkeqësi dhe bela, për hir të dashurisë Tënde, o i dashuri i myslimanëve, o Zot i Madh”.



NATA E KATËRMBËDHJETË

Në këtë natë falen gjashtë rekate namaz, ku në çdo rekat lexohet surja El Fatiha dhe 30 herë surja Zilzaleh.

DITA E PESËMBËDHJETË

Lutja

O Zot: Më mbarëso në këtë muaj duke t’u përulur për shkak të frikësimit nga Ti dhe më hap gjoksin në këtë muaj duke më udhëzuar dhe orientuar qartë, me sigurinë Tënde, o Sigurues i të dobëtëve, o Zot i Madh”.

NATA E PESËMBËDHJETË

Në këtë natë falen katër rekate, ku lexohen: surja El Fatiha dhe 100 herë surja El Ihlas.

Më 15-të Ramazan, të vitit të dytë të Hixhrit, ka lindur Imam Hasan El Muxheteba (Allahu qoftë i kënaqur me të). Në këtë ditë është mustehab (e preferuar) të jepet sadaka dhe të bëhen vepra të mira.

DITA E GJASHTËMBËDHJETË

Lutja

“O Zot: Më mbarëso në këtë muaj duke më bashkuar me të mirët e Tu dhe më largo në këtë muaj nga të këqijat. Më bëj të banoj në parajsë në këtë muaj, për hak të adhurimit Tënd, o Adhurues i të gjithë njerëzisë, o Zot i Madh!”

NATA E GJASHTËMBËDHJETË

Në këtë natë falen 12-të rekate namaz, ku lexohet surja El Fatiha dhe 12 herë surja El Tekathur.

DITA E SHTATËMBËDHJETË

Lutja

“O Zot: Më oriento në këtë muaj në vepra të mira. M’i plotëso në këtë muaj të gjitha nevojat dhe shpresat e mia. O Zot: Ti nuk ke nevojë për sqarime dhe pyetje, o i Dijshmi i gjërave në gjokset e njerëzve, paqja Jote qoftë mbi Muhamedin dhe mbi familjen e Muhamedit (s.a.a.), të pastër dhe të kulluar”.

NATA E SHTATËMBËDHJETË

Në këtë natë falen dy rekate. Në rekatën e parë lexohet surja El Fatiha dhe një sure që ju dëshironi, kurse në rekatën e dytë lexohet surja El Fatiha dhe 100 herë surja El Ihlas.

Mbas namazit thuhet 100 herë 'La ilahe il-la Allah'. Kjo është natë e bekuar sepse në të ka ndodhur Lufta e Bedrit. Është mustahab të japësh sadaka dhe të bësh ibadet.

DITA E TETËMBËDHJETË

Lutja

"O Zot: Më zgjo në të mirat e syfyrit të Ramazanit dhe ndriçoje zemrën time me ndriçimin e dritave të Ramazanit. Bëji organet e trupit tim ndjekës të dritave të Ramazanit, për hir të dritës Tënde, o Ndriçues i zemrave të kuptueshme. O Zot!"

NATA E TETËMBËDHJETË

Në këtë natë falen katër rekate namaz, ku lexohet surja El Fatiha dhe 25 herë surja El Keuther.

DITA E NËNTËMBËDHJETË

Lutja

"O Zot: Zgjeroje fatin tim në këtë muaj në drejtim të mirësive të Ramazanit dhe lehtësoji rrugët e mia në kërkim të begative dhe mos ma bëj haram pranimin e të pëlqyeshmeve të Ramazanit. O Orientues në drejtësi, o Zot".

NATA E NËNTËMBËDHJETË

Në këtë natë falen 50 rekate namaz . Në to lexohet nga një herë surja El Fatiha dhe surja El Zelzeletu. Kjo është nata e parë e Kadrit.

DITA E NJËZETË

Lutje

"O Zot: M'i hap dyert e xhenetit në muajin ramazan dhe m'i mbyll dyert e xhehenemit. Më mbarëso të lexoj Kur'anin Tënd. O Zbritës i qetësisë në zemrat e besimtarëve. O Zot!"

NATA E 20-21-22-23-24: E RAMAZANIT

Në këto net falen 8 rekate namaz dhe në to lexohet surja El Fatiha dhe mbas saj lexohet çfarëdolloj sureje që dëshirohet.

DITA E NJËZETENJËTË

Kjo është dita e vdekjes së Imam Aliut (r.a.). Është e preferuar (mustehab) të bëhet vizitë (zijaret).

DUAJA E DITËS SË NJËZETENJËTË

"O Zot: M'i bëj argumente begatitë e Tua në muajin ramazan dhe mos më bëj të shkoj pas

hapave të djallit. Bëje xhenetin vendbanimin Tim, O Plotësues i nevojave të kërkuesve! O Zot!"

DUAJA E DITËS SË NJËZETEDYTË

"O Zot: M'i hap dyert e dobive të ramazanit dhe m'i zbrit bereqetet e Tua në muajin ramazan. Më mbarëso që të punoj punë të pëlqyeshme tek Ti në muajin ramazan dhe më bëj të banoj në parajsën Tënde. O Përgjegjës i lutjeve të të paaftëve. O Zot!"

DUAJA E DITËS SË NJËZETETRETË

"O Zot: Më pastro prej mëkateve në muajin ramazan dhe më pastro prej të këqijave. Provoje zemrën time me mbështetjen tek Ti, o Pakësues i mëkateve, o Zot!"

DAUJA E DITËS SË NJËZETEKATËRT

"O Zot: Unë mbështetem tek Ti në këtë muaj për ato gjëra që Ti i pëlqen dhe mbështetem tek Ti për ato gjëra të cilat të zemërojnë dhe të lus në këtë muaj që të më mbarësosh me përlulen ndaj Teje dhe që të mos i kundërshtoj urdhrat e Tua, o Dhënësi i pyetjeve, O Zot!"

DITA E NJËZETEPESTË

Lutja

"O Zot: Më bëj në këtë muaj të dashur për evliatë e Tu dhe armik për armiqtë e Tu, zbatues të synetit të Pejgamberit Muhamed (s.a.a.), i cili është vula e pejgamberëve të Tu, o Mbrojtës i zemrave të pejgamberëve, o Zot".

NATA E NJËZETEPESTË

Në këtë natë falen 8 rekate, ku lexohet surja El Fatiha dhe 10 herë surja El – Ihlas.

DITA E NJËZETEGJASHTË

Lutja

"O Zot: M'i bëj ecjet e mia në Ramazan të falënderuara, m'i bëj mëkatet e mia të falura, m'i bëj punët e mia të pranueshme dhe m'i mbulo të këqijat, o Dëgjues, o Zot!"

NATA E NJËZETEGJASHTË

Në këtë natë falen 8 rekate namaz, ku lexohet një herë surja El Fatiha dhe 100 herë surja El Ihlas.

DITA E NJËZETESHTATË

Lutja

“O Zot: Më begato me të mirat e natës së Kadrit, shndërroji çështjet e jetës sime nga të vështira në të lehta, m’i prano lutjet e mia dhe zhduki mëkatet e mia, o Mëshirues i adhuruesve të Tu të singertë, o Zot”.

NATA E NJËZETESHTATË

Në këtë natë falen 4 rekate namaz, ku lexohet surja El Fatiha dhe surja El Mulk. Nëse nuk është e mundur të lexohet surja El Mulk atëherë preferohet që në vend të saj të lexohet 25 herë surja El Ihlas. Në këtë natë është mustehab (e preferuar) larja (gusli).

DITA E NJËZETESHTATË

Lutja

“O Zot: Më begato me të mirat e natës së Kadrit, shndërroji çështjet e jetës sime nga të vështira në të lehta, m’i prano lutjet e mia dhe zhduki mëkatet e mia, o Mëshirues i adhuruesve të Tu të singertë, o Zot”.

NATA E NJËZETESHTATË

Në këtë natë falen 4 rekate namaz, ku lexohet surja El Fatiha dhe surja El Mulk. Nëse nuk është e mundur të lexohet surja El Mulk atëherë preferohet që në vend të saj të lexohet 25 herë surja El Ihlas. Në këtë natë është mustehab (e preferuar) larja (gusli).

DITA E NJËZETENËNTË

Lutja

“O Zot: Më mbulo me mirësinë Tëndë në këtë muaj, më dhuro në këtë muaj mbarësi dhe mbrojtje dhe pastroje zemërimin tim prej akuzimeve dëmtuese, o Mëshirëbërës ndaj adhuruesve të Tu besimtarë, o Zot!”

NATA E NJËZETENËNTË

Në këtë natë falen 2 rekate namaz, ku lexohet surja El Fatiha dhe 20 herë surja El Ihlas.

DITA E TRIDHJETË

Lutja

“O Zot: Bëje agjërimin tim të falënderuar dhe të pranuar, ashtu siç dëshiron Ti dhe ashtu siç dëshiron Pejgamberi Yt. Bëj që degët e agjërimin të jenë të lidhura me parimet e Tij, për

hir të Muhamedit dhe familjes së tij (s.a.a.)

NATA E TRIDHJETË

Në këtë natë falen 12 rekate namaz, ku lexohet surja El Fatiha dhe 20 herë surja El Ihlas. Mbas namazit thuhet 100 salavatë për Muhamedin dhe familjen e tij (s.a.a.).

VEPRIME TË PËRGJITHSHME NË NATËN E KADRIT:

NETËT E 19-ta, 21-ta, 23-ta 25-ta, 27-ta JANË NETËT E BEKUARA

Veprimet në këto net janë:

1-Gusli (larja).

2-Namaze me 2 rekate, ku lexohet surja El Fatiha dhe mbas saj lexohet 7 herë surja El Ihlas.

3-Mbas namazit bëhet 70 herë istigfar (pendim), duke thënë: ‘Estagfirulla ve Etubu llej’.

4-Ndenjja zgjuar.

5-Namaze me 100 rekate, ku lexohet surja El Fatiha dhe surja El Ihlas për çdo rekat.

6-Merret Kur’ani para duarve duke thënë: “O Zot! Unë të drejtohem Ty për librin Tënd të zbritur dhe për atë që gjendet në brendësi të Kur’anit. Dhe në brendësi të Kur’anit gjendet emri Yt i Madhërueshëm dhe cilësitë e Tua të Larta. Të drejtohem Ty për çdo gjë frikësuese dhe shpresuese që ndodhet në Kur’an. Më çliro prej zjarrit Tënd, o Zot!” (kërkoji nevojat e tua).

VEPRIMET NË DITËN E BAJRAMIT

1-Tekbirë mbas namazit të sabahut dhe mbas namazit të Bajramit.

2-Dhënia e Zekatit të Fitrit para namazit të Bajramit.

3-Gusli (larja). Koha e tij është nga agimi e deri para faljes së namazit të Bajramit.

4-Lutja e guslit (larjes): “O Zot, bëje këtë larje pastruese të mëkateve të mia dhe pastroje besimin tim. O Zot, largoji prej meje ndyrësitë”.

5-Veshja e rrobave të bukura dhe përdorimi i erërave të këndshme.

6-Të ngrënit në fillim të ditës dhe para namazit të Bajramit.

7-Shkuarja në xhami për të falur namazin e Bajramit.



Fiter Bajrami

”Çdo ditë në të cilën nuk bëhet mëkat ndaj Allahut është bajram.”

Fiter bajrami është një nga dy festat më mëdha të traditës Islame. Janë regjistruar shumë hadithe dhe rivajete për këtë festë. Muslimanët që kanë agjëruar në muajin e Ramazanit përveç ndërprerjes së ushqimit dhe pijes kanë ndaluar edhe shumë vepra të tjera, dhe pas përfundimit të Ramazanit, në ditën e parë të muajit Sheval kërkojnë nga Allahu i Madh shpërblimet dhe sevapet të veprave që kanë bërë tërë muajin ramazan, sepse këtë Allahu i Madhërishtëm ka premtuar për shpërblim. Në një Fitër Bajram Emirul Mëminin ka mbajtur një hutbe duke përgëzuar besimtarët dhe duke frikësuar të pafetë:

“O ju njerëz! Sot është një ditë, për ata që kanë bërë mirë do të marrin shpërblimin e mirësisë dhe ata që kanë bërë keq do të poshtërohen dhe dëshpërohen. Kjo gjendje është e ngjashme me Ditën e Kiametit. Kështu që kur të niseni për ta falur namazin e Fitër Bajramit në kijam (të ndejturit në këmbë gjatë namazit) mendoni se si një ditë do të dilni nga varri dhe do të dilni para Krijuesit të Madh. Para Tij do të falni namaz dhe kur të ktheheni nëpër shtëpitë tuaja kërkon për vete që: Shtëpitë ku jeni duke u kthyer duhet të jenë si xhenet. O ju robët e Zotit! Shpërblimi më i mirë për femrat dhe meshkujt që kanë agjëruar është: Kur në ditën e fundit të Ramazanit një meleqe u thotë atyre: “Hej! Lajmi i mirë për ju, mëkatet e kaluara janë falur. O ju rob të Allahut! Tani keni kujdes se si do ti kaloni ditët e mbetura.”

VENDI I BAJRAMIT NË KULTURËN E ISLAMIT

Fjala “*ijd*” që ka kuptimin e bajramit rrjedh nga folja *ad-evd=jeud* dhe ka kuptimin: “*të bërit zakon*”, “*shpëtimi nga trishtimi, pikëllimi dhe shqetësimet e thella etj.* “, *dita e mbledhjes së popullit apo ndodhja e një ngjarjeje në popull*”, “ dhe thuhet të përmendet në këtë mënyrë që në vitet e ardhshme të sjell mirësi të reja”

Fjala “*ijd*” është përmendur vetëm njëherë në suren Maide 114, që ka kuptimin e Bajramit në Kur’anin Kerim.

Në komentin e mostrave, në sqarimet për këtë ajet është thënë : “*ijd*”, në fjalor rrjedh nga rrënja “*evd*”, dhe është një fjalë që ka kuptimin “*kthim*”. Për këtë arsye koha e parë e arritjes së fitores së një shoqërie apo populli pas vështirësive është quajtur “*ijd*”. Në lidhje me këtë festat Islame, në muajin e ramazanit ku adhurimi është i lartësuar dhe përmbushjen e Haxhit si një farzë (obligim) i madhe është si një kthim në shpirt të sefasë

së shpirtit dhe fitratit (natyrës njerëzore) të pastër dhe për shkak të pastrimit nga të këqijat është karakterizuar si bajram.

Rivajeti që është transmetuar nga Imam Aliu paqa qoftë mbi të thotë: “*Çdo ditë që nuk i bëhet mëkat Allahut është bajram.*”. Kur lexojmë këtë hadith kuptojmë më mirë çka është bajrami. Është ditë që braktiset mëkati dhe arrihet fitorja dhe ditë e kthimit në natyrën tonë të pastër njerëzore.

Sipas transmetimit të Suvejd bin Gafele :

“Në ditën e Bajramit kur kam ardhur para Imam Aliut a.s. e pashë që afër kishte bukë gruri dhe khatife (një gjellë nga qumështi dhe gruri) dhe melbene (një ëmbëlsirë apo gjellë prej qumështi). Pastaj thashë: “ Në këtë ditë Bajrami po ushqeheni me khatife?!”

Ai u përgjigj: “ Ky, është bajrami vetëm i atij që është i falur.”

Një bajram Pejgamberi s.a.a. ka thënë:

“Sot bajrami është vetëm për ata që i është pranuar agjërimi dhe i është lartësuar adhurimi. Çdo ditë është bajram për të atë që nuk kundërshtojnë urdhratë e Allahut”

USHQIMET E DOBISHME & USHQIMET E DËMISHME GJATË MUAJIT TË RAMAZANIT

**KONSUMIMI I
USHQIMEVE ME
KARBOHIDRATE
TË LARMISHME
DHE I UJIT TË
BOLLSHËM NË
PERIUDHËN NGJA
IFTARI NË SYFYR
JANË PRINCIPET
THEMELORE
GJATË MUAJIT
TË AGJËRIMIT .**



Agjëruesit duhet të evitojnë përdorimin e ushqimeve që përmbajnë karbohidratet të përpunuara si sheqeri, mielli i bardhë, ëmbëlsira me krem, biskota me krem, bakllava, hallva me shumë sheqer dhe yndyrë si dhe mishëra me yndyrë .

Gjithashtu duhet të përdoren më pak pije me kafeinë si çaj, kafe kola, sepse kafeina e shton urinimin dhe për këtë arsye, gjatë ditës agjëruesi ndjen mungesë lëngjesh dhe etj .

Nga ana tjetër, ushqimet me pak yndyra dhe të përgatitura me pak vaj vegjetal, të shoqëruara me patate apo me perime të ziera si dhe me kos, bëjnë pjesë në grupin e ushqimeve më të shëndetshme. Duhet të përdorni ëmbëlsira të përgatitura me qumësht, mjaltë ose lëndë të tjera natyrore kryesisht bimore .

Si ta çelim iftarin?

Hapja e iftarit është një nga çastet më të bukura të agjërimit në të cilat ka begati të shumta. Është mirë që iftari të hapet me ujë të vakët dhe me hurma. Qumështi i ngrohtë, pak bukë me djathë, jeshillëqe dhe supë është ushqimi më i mirë për iftar. Hapja e iftarit me ujë të valuar e të vakët ndihmon në zhdukjen e lëndëve helmuese nëpërmjet urinimit dhe aparatit të frymëmarrjes.

Trupi i njeriut në kohën e iftarit ka nevojë për një burim energjie si glukozja që energjinë e nevojshme e dërgon menjëherë në Kur'an përmendet si frutë i shenjtë dhe që përmendet edhe në disa hadithe të Profetit, është një nga ushqimet më të mira që furnizon trupin me lëndët e nevojshme si glukozja, fibra, kaliumi dhe magnez. Përgamperi s.a.a. thotë: " Çdo kush që agjëron, ta çelë iftarin me hurma dhe nëse nuk gjen hurma, ta çelë me një

ujë të pastër "

Ushqimet e këshilluara nga Hz. Muamed s.a.a.janë: Qumështi, hurma, mishi i deles dhe buka e elbit. Edhe në Kur'an përmenden fruta si hurma, ulliri dhe fiku. Agjëruesi në iftar duhet të hajë ushqim të lehta dhe me energji dhe të evitojnë ushqimet voluminoze, pilaf dhe ushqime të skuqura si dhe ushqime të përgatitura, me qëllim që trupi gradualisht të bëhet gati për darkën.

Rëndësia e ngrënies së darkës gjatë muajit të Ramazanit Darka është një vakt i rëndësishëm ushqimi gjatë muajit Ramazan. Meqenëse gjatë stinës së verës nata është më e shkurtër, agjëruesit këshillohen që më pak kohë pas ngrënies së iftarit të lehtë, të hanë darkë dhe deri dy orë para fjetjes të pinë 2 gota çaj ma pak kafeinë, një gotë qumësht dhe të paktën dy kokrra fruta (sidomos mollë me lëkurë). Por në stinën e vjeshtës dhe sidomos të dimrit, për shkak se nata është më e gjatë, është më mirë që agjëruesit të hanë darkë 3 orë pas ngrënies së një iftari të lehtë. Darka mund të përbëhet nga mishi i bardhë, i kuq dhe peshk, bukë, bulmete, perime dhe fruta. Është më mirë që frutat të konsumohen në fund të darkës ose pas ngrënies së darkës. Pilafi, gjellërat, në përgatitjen e të cilave nuk është përdorur shumë yndyrë, sallata jeshile dhe kosi janë elementë të përshtatshëm për darkën e një agjëruesi .

Syfyri, vakti kryesor i ushqimit në muajin e Ramazanit

Syfyri në krahasim me iftarin dhe darkën, është vakti kryesor i ushqimit. Kjo ka rëndësi më të madhe për personat që gjatë ditës kryejnë aktivitete të shumta mendore dhe fizike si studentët, nxënësit, sportistët, punëtorët

dhe bujqit .

Mungesa e madhe e energjisë tek personat që në mënyrë të gabuar mbajnë agjërimin pa ngrënë syfy, bëhet për shkak për uljen e aktiviteteve gjatë ditës. Personat që agjërojnë pa ngrënë syfy, metabolizmi i trupit të tij shkakton shkon drejt shpërndarjes së parregullt të yndyrave dhe kjo krijon një përbërje e cila në gjuhën e shkencës njihen me termin, trupa ketonikë. Krijimi i këtyre trupave bëhet shkak i erës së keqe të gojës, dhimbje koke, dhimbje të pjesëve të tjera të trupit dhe krijimin e një ndjenje jo të mirë tek njeriu.

Mos ngrënia e syfyrit shkakton uljen e glukozës në gjak shkakton rënien e aftësisë së trupit dhe ndjenje lodhje tek njeriu. Ndryshe nga çka mendojnë disa njerëz, agjërimi pa syfy jo vetëm që nuk shkakton rënien në pe-

shë, por në përgjithësi bëhet shkak për shtimin e peshës. Shkak për këtë është ulja e glukozës në gjak dhe kjo e shtyn agjëruenin që në kohën e iftarit të hajë ushqime të ëmbla dhe me yndyrë. Mos ngrënia e syfyrit dëmton seriozisht shëndetin e adoleshentëve dhe të rinjve në procesin e rritjes. Si rrjedhim, asnjëherë mos e lini pa ngrënë syfyrin.

Regjimi i ushqimor në syfy

Pejgamberi paqja qoftë mbi të dhe Familjen e tij ka thënë; **“ Zoti i Madhërishtëm dhe engjëjt dërgojnë përshëndetje dhe selam, për ata që kanë syfy, prandaj secili prej jush duhet të hajë syfy, qoftë edhe nëse është sa një pikë uji. Syfyri më i mirë është savigh dhe hurma. ”**

Meqenëse syfyri është vakti më i rëndësishëm ushqimor i agjëruenesve, duhen respektuar disa principe bazë disa nga cilat po i përmendim më poshtë:

- 1.Fjetjen programojeni në mënyrë të atillë që të zgjoheni pak më herët që ibadetin dhe adhurimin ndaj Zotit ta kryeni me qetësi dhe syfyrin ta hani pa nxitim
- 2.Gjatë syfyrit përdorni patjetër ushqime të ngrohta e të freskëta .
- 3.Përdorni ushqime me pak yndyrë, pak kripë dhe pak sheqer .
- 4.Gjithë syfyrit përdorni ushqime të larmishme dhe jo çdo syfy të keni të njëjtin menu .
- 5.Karbohidratet që përdorni gjatë syfyrit duhet të jenë të larmishme dhe jo karbohidrate të thjeshta të cilat durojnë vetëm 3-4 orë në trupin e njeriut. Karbohidratet e larmishme qëndrojnë deri 8 orë në sistemin e tretje dhe agjërueni ndjen uri shumë vonë. Në karbohidratet e larmishme bëjnë pjesë buka dhe drithërat e tjera (orizi, elbi) patatja, thjerëza, fasulja si dhe frutat dhe perimet.
- 6.Duhet të përdorni sa më pak ushqime të skuqura sepse bëhen shkak për djegie në stomak dhe për shtimin e etjes gjatë agjërit .
- 7.Gjatë syfyrit evitoni ngrënien e ëmbëlsirave, ushqimeve të kripura, me yndyra sepse këto lëndë ushqimore bëhen shkak për shtimin e etjes gjatë ditës .
- 8.Evitoni pirjen e dhallit (për shkak të kripës dhe yndyrës që ka), të pijeve me gaz dhe të pijeve me ëmbëltues.
- 9.Konsumoni kos dhe sallata të ndryshme si dhe supë elbi gjatë syfyrit .
- 10.Evitoni pirjen e çajit dhe kafesë në kohën e syfyrit, sepse ato shtojnë urinimin duke bërë shkak për shtimin e etjes gjatë ditës .
- 11.Gjatë syfyrit mos hani ushqime të thata si qofte dhe qebapë të ndryshëm me mish të kuq. Këto ushqime sidomos kur shoqërohen me erëza, shtojnë etjen dhe bëhen shkak për ulcerën në stomak .
- 12.Mos konsumoni ëmbëlsira me sherbet, hallvë me yndyrë, majonezë, sallam, salsicë dhe ushqime të përgatitura jashtë (fast food).
- 13.Për të ulur etjen, mund të konsumoni limon, kos dhe jeshillëqe të freskëta .
- 14.Mos u shtrini menjëherë pas syfyrit sepse ky veprim shkakton ç'rregullime në aparatën e tretjes .

SHKURORI

Të dashur, zonjë e zotëri! Për hir të dashurisë ndaj Allahut dhe për fëmijët tuaj të pajshëm jini të mëshirshëm ndaj njëri tjetrit. Mos i stërmadhoni problemet tuaja të thjeshta dhe mos bëheni këmbëngulës në grindjet tuaja. Mos kritikoni njëri tjetrin

Edhe pse shkurorëzimi është akt ligjor (sipas Sheriatit, sh.p), është më i nevojshëm e më i papëlqyeshëm nga të gjitha veprat.

Imam Sadiku a.s. ka thënë: "Martohuni por mos u shkurorëzohuni, sepse shkurorëzimi do ta trondit arshin (fronin) e Allahut" gjithashtu ka thënë: ***"All-llahu e do një shtëpi që e ka mbushur martesë, ndërsa nuk e do një shtëpi që e ka zbrazur shkurorëzimi"***.

Kurora nuk është sikur blerja e këpucëve ose çorapëve, po që se nuk i pëlqejnë njeriut, i ndërron. Kurora është një kontratë shpirtërore që i lidh dy persona me qëllim të jetuarit bashkë si miq ose dashnorë gjer në vdekje. Vajza e re braktis prindërit e vet dhe kalon në shoqërim të bashkëshortit të vet, duke u mbështetur në atë shpresë të madhe.

Mashkulli për këtë kontratë të shenjtë vepron me shumë mundime. Merr për sipër harxhimet dhe vepron për një harmoni familjare. Kurora nuk është një aferë epshmërie dhe që çifti bashkëshortor mund ta shkatërrojë atë për shkak të gjërave të thjeshta. Edhe pse shkurorëzimi, ligjërisht është i lejuar, në të vërtetë është i ndytë, ndërsa njerëzit porositen që t'i ikin me aq sa kanë mundësi.

Fatkeqësisht ky akt shumë i ndytë është bërë i natyrshëm, ndërsa themelet e bashkëshortësisë familjare aq shumë janë tronditur sa që, përgjithësisht, në kurorën ka



ËZIMI

Dr. Murtaza Mutahhari

mbetur shumë pak besim. Shkurorëzimi është i lejuar por vetëm në rrethana të veçanta dhe të patjetërsueshme.

Pejgamberi s.a.a. thotë: "Aq shumë Xhibrili ma ka tërhequr vërejtjen për shkak të grave, sa që mendova se njeriu nuk ka të drejtë të ndahet prej tyre, përveç nëse ato shkelin kurorën".

Shumica e rasteve të shkurorëzimit nuk janë të bazuara në arsye të shëndosh, por në disa arsye të papjekura. Gjegjësisht, në të shumtën e rasteve arsyet janë të thjeshta dhe nuk vlejné për shkurorëzim. Burri ose gruaja, nga egoizmi, mund ta stërmadhojnë problemin e thjeshtë dhe të vendosin për shkepütjen e kurorës.

Një zonjë njëzetepesë vjeçe e luti bashkëshortin e vet që t'i ftojë prindërit e saj në një darkë të përbashkët. Meqë ai nuk ia pranoi lutjen, ajo dha aktpadi për shkurorëzim. Burri ndahet nga gruaja e vet për shkak se ajo lind vetëm vajza. Ata kishin pesë vajza.

Gruaja vendosi të ndahet prej burrit, sepse ai besonte në misticizëm dhe nuk tregonte shumë interes për jetën. Bashkëshorti vendosi të ndahet nga bashkëshortja e vet sepse dëshironte të martohet me një pasanike. Gruaja vendosi të ndahet nga burri i saj, sepse ai e kishte zakon t'i fshehtë paratë nëpër mëngë etj etj.

Çifti bashkëshortor që nuk është i mençur dhe i arsyeshem mund të bie në kurthin e arsyeve të vogla dhe të kërkojë shkurorëzim. Çifti i cili kërkon ndarje, nuk guxon të shpejtojë në atë. U sugjerohet bashkëshortëve që në detaje t'i shikojné pasojat dhe ardhmërinë e vet e pastaj të vendosin.

Ata veçanërisht duhet t'i mbajnë mend dy gjëra:

E para: Bashkëshortët që kërkojnë shkurorëzim, kryesisht do të dëshironin që sërish të martohen. Por ata duhet të kenë ndërmend se pas shkurorëzimit, personi i cili dihet se është shkurorëzuar nuk do të ketë porosi të mirë për martesë. Njerëzit e konsiderojné egoistë e të pabesueshëm. Pasi të kuptohet për kurorëzimin e parë dhe për shkurorëzimin e burrit, gruaja mund të dyshojë në besueshmërinë dhe në karakterin e tij në përgjithësi. Gruaja e shkurorëzuar rrallë herë mund të ketë shpresë për martesë të sërishme. Kjo ngjan nga shkak se meshkujt, kryesisht, nuk tregojné shumë interesim për gruan e shkurorëzuar dhe dyshojné në besueshmërinë e saj.

Prandaj gruaja e shkurorëzuar me siguri mund të mbetet e vetmuar gjer në fund të jetës së vet dhe mbase mund të vuajë nga vetmia. Shumë vështirë është të mbetesh i vet-

muar, ashtu që disa njerëz të vetmuar më tepër e dëshirojnë vdekjen se sa një jetë të tillë të padurueshme.

Mashkulli, bile edhe nëse ka sukses në martesën e sërishme, në asnjë mënyrë nuk mund të jetë i sigurt që gruaja e tij e dytë do të jetë më e mirë se e para. Ajo mbase mund të jetë më e keqe. Meshkujt e këtillë shpesh herë i nënshtrohen shkurorëzimit edhe me gruan e dytë dhe zakonisht e vajtojnë të parën. Por, zakonisht, për një goditje të tillë vonë është.

Një plak tetëdhjetë vjeçar deklaroi para gjyqit: "Kam pasur një jetë të mirë atëherë kur u martova me gruan e parë, përafërsisht para gjashtëdhjetë vjetëve. Por nuk zgjati shumë kohë pas kësaj, ajo filloi të sillet keq ndaj meje, andaj u ndava prej saj. Pastaj jam martuar disa herë, por vërejta që gruaja ime e parë ishte më besnikja nga ato. E takova dhe e luta që të martohemi përsëri. Ajo, gjithashtu e lodhur nga vetmia, pranoi, e tani dëshirojmë që përsëri të vëmë kurorë".

Një mashkull u nda nga bashkëshortja e tij e dytë, sepse nuk mund të kujdesej për dy fëmijët që i kishin mbetur nga martesja e parë. Ai përsëri martohet me gruan e parë, prej të cilës u nda para pesë viteve. Një çift bashkëshortor i cili kërkon ndarje, patjetër duhet gjithashtu të mendojë për fëmijët e vet. Mirëqenie e fëmijëve gjen prehje në familjen në të cilën që të dy prindërit jetojnë bashkë dhe së bashku kujdesen për ta.

Pas shkurorëzimit fëmijët bëhen shumë të shqetësuar. Nëse vetëm babai kujdeset për ta, do t'u kufizohej dashuria e nënës. Ata, po ashtu, nuk mund të çojné jetë me njerken. Njerkat jo vetëm që janë të paafta të sillen me ata sikur nëna të vërteta, por mund që thjesht të tyre t'i konsiderojné ngarkesë. Disa njerka i torturon thjesht të tyre dhe me qëllim i demoralizojné, ndërsa baballarët e tyre, mbase nuk guxojné të reagojnë.

Një nuse 20 vjeçe e cila provoi të bëjë vetëvrasje, deklaroi në spital: "Prindërit e mi janë ndarë kur kam qenë një vjeçe. Pas një vit e gjysmë, babai u martua përsëri e tani jetojmë së bashku. Njerka ime më rrihte, bile disa herë më ka djegur me thupër të nxehtë metali. Babai edhe pse ishte njeri i pasur, nuk më lejoi të vazhdoj shkollimin dhe ma mori të drejtën e mësimi. Përafërsisht para një muaji më detyroi të martohem për një burrë dyzetepesë vjeçar". Një vajzë trembëdhjetë vjeçe është varë. Kjo jetonte me dy vëllezërit e saj. Njëri nga dy vëllezërit deklaroi: "Prindërit

e mi janë shkurorëzuar para tre vjetëve. Nëna ime u martua për një burrë tjetër, ndërsa babai vdiq para dy muajsh. Dje në ora 6.30 kur erdha në shtëpi, e gjeta motrën e varur”.

Gjithashtu, nëse nëna merr përgjegjësinë mbi familjen e vet, atëherë zë vendin e një babai të vërtetë që do të kujdesej për ta. Njerku shpesh herë është shkaktar i shumë të këqijave të thjeshtë të vet. Një grua i ndihmoi burrit të dytë që ta lidh për krevati thjeshtit e vet tetë vjeçar. Pastaj ia mbyllën dyert dhe shkuan të shëtisin. Kur u kthyen në shtëpi e gjetën fëmijën e kallur, sepse në shtëpi ishte shkatuar zjarr”.

Shkurorëzimi shkatërron bashkësinë familjare dhe bën që fëmijët të enden pa pasur vendstrehim. Fëmijët vuajnë shumë nga egoizmi i prindërve të tyre. Katër fëmijë të moshës dymbëdhjetë, nëntë, gjashtë dhe katër vjeçe shkuan në stacionin policor. Djali më i madh tha: ”Jo shumë kohë më parë u shkurorëzuan prindërit tonë. Ata gjithnjë kishin mosmarrëveshje, qortoheshin natë e ditë. Tani kur u shkurorëzuan asnjëri nuk është i gatshëm që të marrë përgjegjësinë mbi ne.

Fëmijët e privuar nga një tutor përkatës dhe nga një atmosferë familjare shpesh herë humbasin rrugën.

Mungesa e arsimit përkatës dhe e personit ngushëllues në jetën e tyre shkakton kompleks inferioriteti. Ata gjatë fëmijërisë dhe moshës më të pjekur, bile mund të bëjnë krime të natyrave të ndryshme. Këtë fakt mund ta kuptojë njeriu vetëm nëse i lexon ngjarjet që dalin nëpër gazetatat e përditshme.

Në një hetim të bërë në Qendrën për rehabilitim të rinjve është evidentuar që prej 116 delikuentve nga kjo Qendër, tetëdhjetë prej tyre pohojnë se sjelljet e njerëve ndaj tyre janë shkaktar i krimeve të tyre”.

Të dashur, zonjë e zotëri! Për hir të dashurisë ndaj Allahut dhe për fëmijët tuaj të pafajshëm jini të mëshirshëm ndaj njëri tjetrit. Mos i stërmadhoni problemet tuaja të thjeshta dhe mos bëheni këmbëngulës në grindjet tuaja. Mos kritikoni njëri tjetrin. Mendoni në ardhmërinë tuaj dhe të fëmijëve. Mbani mend! Fëmijët tuaj në ju mbështeten dhe prej jush kërkojnë lumturinë.

Keni mëshirë ndaj tyre dhe mos ua shkatërroni jetën. Nëse nuk i përfillni dëshirat e tyre të brendshme dhe nëse ua thyen zemrat e tyre të vogla, nuk do të jeni në gjendje t’u ikni pasojave të fatkeqësisë së tyre. Për këtë shkak nuk do të jeni në gjendje të jetoni së bashku në një jetë të rehatshme.



PYTJE DHE PËRGJIGJE

NË DILEMAT DHE PYETJET TONA PËRGJIGJET PROF . DR. AKBAR EYDI

AFTËSITË E MAGJISTARIT

Pyetje:

A janë xhinët të aftë t'i lexojnë mendimet e personit në të cilin kanë ndërhyrë dhe a ka mundësi që këto mendime pastaj t'ia përcjellin magjistarit?

Përgjigje:

Në emër të Allahut Mëshiruesit , Mëshirëbërësit .

Magjistarët përdorin dobësitë shpirtërore dhe dobësitë mendore të njeriut , ata janë si edhe njerëzit të cilët një kohë ushtrojnë dhe aftësohen (keramete) , andaj pas kësaj ata natyrisht se mund të fitojnë ata të cilët nuk janë trajnuar dhe ushtruar mirëpo në momentin që hasin në dikë të fuqishëm dhe të fortë me siguri se do të dështojnë .

Andaj , nuk duhet kushtuar vëmendjen të folurit të tyre dhe as t'i dorëzohemi porse duhet mundur ata me vetëbesim personal . Në 99% të rasteve rrëfimet se si dikujt i është bërë magji ose se xhinët janë në shërbim të magjistarëve nuk ka lidhje me realitetin , por ato trillohen dhe përhapen nga mashtrues që kanë për qëllim lajthitjen e njerëzve dhe fitimin e parave.

Nëse ata thonë të vërtetën dhe nëse xhinët janë në shërbim të tyre dhe se mund t'i lexojnë mendimet e njerëzve , a mos vallë , edhe me gjithë këto “aftësi” , do të pranonin që ata të bënin një jetë të mjerë dhe prej lypsarësh?

Rrjedhimisht , lexues i nderuar , mos i merrni në konsideratë ato rrëfime dhe mos lejoni të mashtroheni , jetën tuaj materiale dhe shpirtërore mos e dorëzoni në duar të mashtruesve dhe të fjalëve pa kurrfarë mbështetje , ngase Allahu i Lartësuar na ka dhuruar arsyen dhe që përmes saj ta ndërtojmë një rrugë jetësore të drejtë dhe na ka dërguar Profetë që të na ndihmojnë për ta arritur fatmirësinë e kësaj dhe botës tjetër .

NË MARTESË ME NJERIUN E FESË TJETËR

Pyetje:

Në martesë kam hyrë relativisht e re me njeri të fesë tjetër! Ende nuk kemi fëmijë , dhe sapo më shkon mendja se nga kjo martesë mund të lindë jobesimtarë dhe kjo po më bren në qenie! Nuk kisha qenë e vetëdijshme për rëndësinë e asaj që kam bërë! E lus Allahun çdo ditë të më udhëzoj se çfarë të bëjë! Nuk mund ta pranoj dhe ta barti atë që do të pasonte pas kësaj (lindjes së fëmijëve)! Dhe nuk mund ta pranoj familjen e tij! Ndërsa pikëllohem menjëherë sapo e mendoj shkurorëzimin , ngase është shumë njeri i mirë dhe e dua! Para se të njiheshim , rregullisht e falja çdo namaz , nuk jam e mbuluar dhe e lusja të Lartësuarin të ma japë një njeri të mirë për martesë! A është ky njeri si përgjigje në lutjet e mia drejtuar Allahut , apo është sprovë të cilën ende nuk e kam kaluar , nuk e di! Një hoxhë më ka thënë se Allahu i bashkon shpirtrat qysh para lindjes?!

Përgjigje:

Në emër të Allahut Mëshiruesit , Mëshirëbërësit

Ajo se Allahu i Lartësuar i ka bashkuar shpirtrat para se ato të lindin nuk do të thotë se ne nuk kemi zgjedhje dhe që duhet dhunshëm të hymë në lidhje martesore , ngase në atë rast as që do të kishim obligime dhe detyra , andaj një interpretim dhe arsyetim i tillë nuk është e pranueshme në dispozitat e të Drejtës Islame . (Fikhut)

Nga pikëpamja e pasuesve të shkollës së Ehli Bejtit një martesë e tillë nuk është në rregull (e drejtë) , mirëpo ju drejtojuni Institucionit fetar përgjegjës të Bashkësisë Islame për këtë çështje dhe të kuptoni se cili është obligimi juaj i sheriatit dhe fetar . Besimi është ai që mund t'ua përmirësoj edhe këtë edhe Botën tjetër . Por gjithsesi , është detyrë e juaja t'i drejtoheni Institucionit fetar përgjegjës në Bashkësinë Islame për të qartësuar obligimin tuaj.

SI TË HARROHET E KALUARA ?

Pyetje:

Prof. Dr. Akbar Eydi

Selam! Kemi 6 vite martesë me bashkëshortin tim dhe gjatë kësaj kohe na kanë lindur dy vajza. Në filim të martesës gjithçka ishte bukur dhe në pajtim të mirëfilltë. Mirëpo, që para 2 vitesh burri filloi të ndryshoj, nuk i kushtonte rëndësi familjes, ndërsa rastësisht zbulova se ka një telefon tjetër dhe çfarë të shohësh në të?! Marrë vesh se ka edhe një femër tjetër, gjë të cilën ai e pranoi dhe më lutet që t'ia fali këtë gabim, që fëmijët të mos mbeten jetim. Megjithatë që jetojmë ende bashkë, por kurrsesi nuk do ta harrojë këtë ngjarje. Ju lutem të më këshilloni se si ta harroj këtë ngjarje dhe a ka ndonjë lutje që do të më qetësonte, se kjo gjendje po më vret shpirtërisht.

Përgjigje:

Në emër të Allahut Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

Motër e nderuar, të gjithë ne kemi mëkate, gabime dhe probleme të cilat - po të shfaqeshin sheshit - do të kishte të tillë që nuk do të na i falnin dhe nuk do të praninin të bashkëjetonin me ne. Diku në vetmi dhe pa anime fillojnë të përsiatni drejtë për jetën tuaj dhe ta pyesni a mos ndoshta gjatë jetës suaj edhe ju keni pasur ndonjë problem moral ose një raport jo islam, se mos ju ka ndodhur që edhe zemra juaj ndonjëherë të ketë rrahur për dikë tjetër? Nëse përfundoni se këto gjëra nuk ju kanë ndodhur, atëherë nga mirënjohja ndaj pastërtisë së zemrës dhe shpirtit tuaj faleni burrin tuaj, me qëllim që Allahu i Lartësuar ta ruaj pastërtinë tuaj. Nëse, megjithatë një gjë e tillë ju ka ndodhur, a do të donit që ato t'ju dalin sheshit dhe që burri juaj të merr vesh për sekretet tuaja? Nëse nuk do të kishit dëshirë që tu duken gabimet tuaja të fshehta - e kjo gjë është e sigurt - atëherë edhe ju duhet t'ia falni gabimin dhe falënderojeni Allahun që burri ju detyrohet (ju kërkon falje) juve.

Ngaqë, nëse një ditë të metat do të shfaqeshin - ngase jo domosdoshmërisht mangësitë e një njeriu pasqyrohen vetëm përmes raporteve të pamoralshme me të tjerët, përkundrazi, ka edhe qindra të meta e mangësi të tjera të cilat nëse do të bëheshin të dukshme, secila nga ne prej tyre do të mund ta turpëronte njeriun - atëherë ju nga gjendja e një kërkuesi të borxhit kaloni në gjendjen e borxhliut. E kjo donë të thotë një mosmirënjohje në raport ndaj fshehjes së sekreteve nga ana e Allahut që nuk kishte turpëruar.

Nga ana tjetër: supozoni se këtë nuk do ta harroni dhe do të vazhdonit të jetonin me këtë vrer dhe për pasojë burri juaj i lodhur nga hidhërimi juaj një ditë t'ju thotë: "Nga sot e tutje unë do të miqësohem me kë të më dojë zemra dhe do të vendosi raporte me kë dua, ndërsa edhe ti bënë çfarë të dojë zemra jote." Çfarë tjetër do të jetë përgjigjja jote atë ditë përveç se t'i thoni: "Jo, më falë, kjo më nuk do të përsëritet!". Me atë rast ju vetveten

do ta përmbysnit nga një gjendje fisnikërie në gjendjen e përluljes dhe me atë rast bëheni ju që duhet ta ndjeni nevojën e faljes së tij, ose do t'i thuash: dua të shkurorëzohem, a mos me këtë rast do të kishit një fat më të mirë?!

E para: a pritni një fat më të mirë, në situatën kur nga një grua e martuar dhe me dy fëmijë dhe me familje të respektuar do të shndërroheni në një vejushë, e cila në sytë e dikujt do të ndjellë dhembshuri, ndërsa te dikush tjetër do të dukesh një krijesë e dobët dhe pa inteligjencë, apo madje në sytë e personave të tretë do të jesh i personifikuar si një rast i mirë për kënaqësi afatshkurtra, pas të cilës ju braktisin.

A do të kishit dashur të keni një jetë me këso karakteristika? Jam i sigurt se përgjigjja jote është negative, ngase një jetë e tillë nuk ia vlen. Krahës gjithë kësaj, çfarë do të jetë fati i vajzave tua të cilat kanë nevojë për ty edhe për babain? Nëse ato në jetën e tyre ballafaqohen me një problem të njëjtë, si tuajin - a do të kenë të ardhme dhe jetë të lumtur? Kur të kuptojnë se babai e ka tradhtuar nënën, çfarë ndjenjash do të kultivojnë ndaj babait? Ose kur të kuptojnë se nëna nuk është në gjendje t'ia falë babait gabimin dhe për ta shpëtuar familjen nga morali i keq, shqetësimeve dhe nga jeta e ndarë, çfarë do të jenë ndjenjat e tyre për të ardhmen?

Sa i përket lutjes, çfarë lutje të lexoni? Nuk ka nevojë për ndonjë lutje të veçantë, porse lutja juaj të jetë pikërisht në shenjë falënderimi për atë që nuk keni mangësi ose ndaj asaj që Allahu i Lartësuar i ka mbuluar mangësitë tua, prandaj duhet të falni dhe harrojeni këtë gabim të burrit tuaj dhe vazhdoje jetën në paqe.

Më e mira e gjithë kësaj është se burrin tuaj e keni larguar nga një vepër e keqe dhe se ai më nuk do të bëjë kësi lloj vepre në kundërshtim me shëritin, moralin dhe obligimet njerëzore. Pra duke qenë mirënjohëse dhe falënderues për gjithë këto të mira, harrojeni të kaluarën dhe kthejuni të ardhmes dhe mos e prishni për hir të së kaluarës.

Shpresoj se do të keni sukses në këtë.

Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë me ju!

Të nderuar miq, për herën tjetër do të e pyesim Dr. Eidin nga Sarajeva, që të na qartësojë më mirë: -Pse një femër myslimane nuk lejohet të martohet me të krishterë, si dhe a lejohet një mashkull mysliman të martohet me një femër të krishterë ?



Dashuria dhe arrija e qëllimeve

Për shkak të nevojës së fëmijëve për dashuri dhe dhembshuri, disa prindër e shfrytëzojnë këtë nxitje të fëmijëve të tyre për t'i arritur qëllimet e veta. Ata kërkojnë nga fëmijë e tyre t'i bëjnë gjërat e caktuara ose përndryshe nuk do t'i duan ata. Padyshim që, një shkallë e kontrollit mund të ushtrohet ndaj fëmijës në këtë drejtim, por, nëse vazhdohet me këtë strategji për një kohë më të gjatë, kjo mund të jetë e dëmshme, sepse fëmija mund të fitojë shprehitë e kryerjes së gjërave vetëm për të kënaqur prindërit dhe jo për të fituar leverdi për vete dhe për shoqërinë. Ai fillon të vendosë lidhur me arsyen e punës duke marrë për bazë kënaqjen e ndonjërit. Ai nuk është i ndërgjegjshëm për at se veprat e tij do të shndërrohen në mbarëvajtjen e shoqërisë dhe të njerëzimit në përgjithësi. Janë shumë, prindër që vlerësojnë përfitimin personal më shumë se të mirën e shoqërisë. Fëmijët e tyre bëhen lajkatarë, hipokritë dhe mashtrues, sepse qëllimi i tyre në jetë bëhet kënaqja e të tjerëve me çdo kusht. Prandaj, mentori i mençur dhe i matur nuk do të shfrytëzojë dashurinë dhe dhembshurinë e fëmijëve për qëllime personale egoiste.

FJALËT E URTA MES PERSISHTES SHQIPES DHE ARABISHTES

MUHAMED MUFAKU (ARNAUTI)

Është shkruar shumë për fjalët e urta popullore dhe për atë çka i përngjan përvojës historike të çdo populli e marrëdhënieve të tij me popujt fqinjë, në proverbat spontane, të cilat nuk njohin kontroll dhe depërtojnë kufirin midis shteteve, ku gjejmë imazhe të tjera me çdo kuptim të karakteristikave të dëshirueshme apo të padëshirueshme. Nga ana tjetër, kemi shumë fjalë të urta që pasqyrojnë përvojën e përbashkët të popujve, kemi disa thënie të ngjashme, madje edhe të njëjta, gjë që shpjegon edhe praninë e saj në afërsinë, lidhjen ose në komunikimin e lirshëm të përvojës së përbashkët nëse ka pasur distanca të largëta gjeografike.

Në këtë kontekst, theksohet se popujt që kanë jetuar brenda Sulltanatit Osman kanë disa thënie të përbashkëta apo të ngjashme, siç është rasti me turqit, arabët, kurdët, shqiptarët dhe boshnjakët. Kjo çështje shpjegohet me lehtësi me sundimin e jetës së përbashkët e cila zgjati 400-500 vjet midis këtyre popujve, në kuadër të një shteti të vetëm me një kulturë të vetme (islame) të mbledhur midis tyre. Këtu përmendim prej fjalëve të urta ose anekdotat e Nasredin Hoxhës ose i njohur në gjuhën arabe me emrin Xhuha.

Kohët e fundit në Tiranë është botuar libri me titull “Fjalë të urta perse” të përkthyer nga gjuha ruse, por përkthimi fjalë për fjalë lokalizoi një çekuilibër Ky është një përkthim i fjalëpërfjalshëm në ekuivalentin e fjalëve të urta shqiptare. Ajo u përkthye nga Drita Lazardi e cila është profesore e gjuhës dhe letërsisë ruse në universitetin e Tiranës, ku shfaqti interes për proverbat popullore. Ajo ka qenë e prirur për një kohë të plotë pas daljes në pension për këtë, dhe ka punuar për përkthimin e librit persian “Proverba perse” botuar nga Akademia e Shkencave e Tashkistanit në gjuhën ruse. Përkthyesja ka pranuar se ka harxhuar vite për kujdesin e gjetjes së ekuivalentit të këtyre thënieve persiane në proverbat shqiptare, ku ajo nuk ka dashur ta fokusojë punën e saj vetëm në përkthimin e tyre.

Kështu, në mes të proverbave perse dhe atyre shqiptare gjejmë fjalë të urta identike me fjalët e urta arabe, si p.sh.: “Kam frikë prej imagjinatës së tij” ose “S’ka ç’ti bëjë gomarit e i bie samarit.”



Fjalë të urta të ngjashme në mes të proverbave persiane dhe atyre shqiptare është dhe “Hajduti specialist fillimisht shuan llambën”, por ne gjithashtu kemi disa fjalë të urta të ngjashme në kuptim por të ndryshme në shprehje, si p.sh. një fjalë e urtë persiane “Shkuli mjekrën e tij vetë” dhe anekdota shqiptare “Shkoi çjapi me këmbët e tij tek kasapi,” dhe fjala e urtë persiane “Njeriu ka nevojë të përdorë mendjen përpara forcës” dhe fjalës së urtë shqipe “Nëse s’ke mend nuk të bën dobi as pasuria dhe as gjëja”, dhe fjala e urtë popullore persiane “Majmuni nuk është i aftë për gdhendjen e drurit” ngjan me fjalën e urtë shqipe “Mos e le ujkun të mbrojë delet”... dhe kështu me radhë.

Prej elementeve të përbashkëta mes proverbave perse dhe thënieve popullore shqiptare ka një imazh tjetër, që përfshin edhe imazhin arab. Këtu duhet theksuar se, në shprehjet historike të dy popujve arabi lidhet me ngjyrën e zezë deri aty sa është përdorur si sinonim i tij në gradën e përdorimit “arabi i zi.” Kështu në proverbat perse gjejmë: “Qymyri i zi nuk zbardhet me sapun,” kurse në fjalët e urta shqiptare thuhet “Sapuni lodhet kot me arabin,” që do të thotë se arabi nuk zbardhet kurrë sado sapun që të harxhohet.

Është e natyrshme që të jenë gati 1700 fjalë të urta perse në këtë libër të cilat reflektojnë specifikat e përvojës historike të persianëve me shtetin, arsimin e çështje të ndryshme. Kështu, në këto fjalë të urta gjejmë atë çka


pasqyrojnë ankesat e taksave të rënda, të tilla si p.sh. “Taksat shtetërore janë si dimri që nuk harrohet,” dhe “Më e lehtë është të mbash hekurin e përvëluar sesa të mbash punët e princit,” dhe “Kur Ahmed i vendosi të shkojë te mësuesi, ai zbuloi se sot është e premte,” dhe “Nëse ftesat e djemve do të gjenin atë që do t’u përgjigjej atyre, nuk do të mbesë asnjë mësues”... e kështu me radhë.

Për sa i përket ngjashmërisë midis proverbave shqipe dhe arabe, vërejmë qartë se cilat janë burimet e mbledhjes së fjalëve të urta shqipe, veçanërisht të “Bleta shqiptare” (1878) dhe të “Dallgët e detit” (1908) ku përfshijnë atë që i përshtatet shqiptarëve të Egjiptit. Duhet theksuar këtu se bashkësia shqiptare në Egjipt ishte një nga komunitetet më të rëndësishme shqiptare jashtë vendit,

më aktive dhe, në Aleksandri, botoi librin e parë tërësor të folklorit shqiptar “Bleta shqiptare” të studiuesit dhe poetit Thimi Mitko (1820-1890), e më pas nxorën librin “Dallgët e detit” të studiuesit dhe poetit Spiro Dini (1848-1922).

Në këto dy burime të para të fjalëve të urta popullore, gjejmë disa fjalë të urta arabe e shqipe, identike ose të ngjashme, si p.sh.: “Çfarë të mbjellësh do të korrësh,” “Punën e sotme mos e lër për nesër,” “Puna e tregon njeriun,” “Ka gjetur tenxherja kapakun,” “Shoku i mirë të çon në rrugë të mirë,” “Shikon qimen në sytë e të tjerëve dhe nuk shikon traun në sytë e tij” e kështu me radhë.

Përktheu nga gjuha arabe: Rezarta SALIAJ



FJALË TË URTA PERSE:

- Mos hap një derë që s’do të mund ta mbyllësh kurrë.
- Etja e zemrës nuk shuhet me një pikë ujë.
- Megjithëse prodhuesi i rrogozëve di të endi, atë nuk e çojnë në punishten e mëndafshit.
- Nëse në mesditë mbreti të thotë se bën natë, sodit yjet.
- Mund të lahet fustani, por jo ndërgjegjia.
- Uji i trëndafilut nuk është për shpinën e pleqve, por për gjokset e të dashurave.
- Kush humbet kredinë, është gjysëm i varur.
- Në hotelin e vendimit, njerëzit flenë rehat.
- Dëshpërimi është shumë më i dhimbshëm sesa durimi.
- Qentë le të lehin, karvani shkon përpara.
- Kush djeg shtëpinë ngrohet të paktën një herë.
- Varri ynë i vërtetë nuk është në tokë, por në zemrat e njerëzve.
- Dita ka sy, nata veshë.
- Puthe një dorë që nuk mund ta presësh.
- Ajo që ha bëhet pleh, ajo që jep, trëndafil.
- Një dorë e butë drejton një elefant me një qime floku.
- Kush flet mbjell, kush dëgjon vjel.
- Dielli është njësoj si për fijen e barit ashtu dhe për cedrin.
- Druri digjet më mirë kur përziehet me drurë të tjerë.
- Katër gjëra kemi më shumë nga ç’pandejmë: mëkate, borxhe, vite dhe armiq.
- Një kokë pa tru duhet prerë.
- Nuk vilet fruti i lumturisë nga pema e padrejtësisë.
- I mbyturi kapet pas litarëve të erës. (Instinkti)
- Dehja nga rinia është më e fortë sesa dehja nga vera.

FEMRAT E LIRA DHE TË MJERA

Sot qeveritë perëndimore dhe në veçanti Amerika, pretendojnë se mbrojnë të drejtat e grave në botë ndërkohë që ato këto të drejta i përdorin si mjet për të goditur vendet e tjera dhe sidomos vendet muslimane. Kjo është në kohën kur vetë këto shtete shkelin të drejtat parimore të femrave. Edhe pse sot femrat në vendet perëndimore kanë arritur të fitojnë disa prej të drejtave të tyre, mirëpo në këto vende vazhdon shkelja qartazi e të drejtave të tyre.



Uendi Shelit (Wendy Shalit), shkrimtare e diplomuar në degën e filozofisë në Amerikë në librin e saj të titulluar **“Feminizmi në Amerikë”** shkruan: E vetmja mundësi e krijuar në shoqërinë tonë mono-gjinore është mundësia për shfrytëzimin e femrës. Kjo është mundësia për agresion, dhunim seksual, dhunë fizike dhe mundësi e barabartë me vdekjen. Kjo shkrimtare thotë se edhe ligjet e gjykatave mbi barazinë gjinore mes burrit dhe gruas në asnjë mënyrë nuk garanton lirinë e femrës.”



Viktor B. Kline shkrimtar amerikan thotë: Hulumtimet e shumta dëshmojnë shqetësimet mbi rastet e përdhunimit të femrave në Amerikë, kanë krijuar një problem serioz që është në rritje. B. Kline flet për takimin komitetit juridik të Senatit amerikan dhe thotë: **“Ku takim përfundoi në kohën kur shpejtësia e rritjes së rasteve të përdhunimeve përgjatë dekadës së kaluar ka qenë 4 herë më e lartë sesa e krimeve të tjera. Në realitet Amerika për nga numri i rasteve të përdhunimeve, renditet e para në botë. Niveli i këtij krimi në SHBA është 4 herë më i lartë sesa i Gjermanisë, 13 herë më i lartë sesa i Anglisë dhe 20 herë më i lartë sesa i Japonisë.”**



Ted Bundy, autori i vrasjeve seri përgjegjës për vrasjen e 30 vajzave të reja në Amerikë përpara ekzekutimit të tij me vdekje mbajti një intervistë dhe tha: **“Ju doni të më ekzekutoni dhe kjo do ta shpëtojë shoqërinë nga unë, mirëpo atje jashtë shumë njerëz janë infektuar me degjenerimin dhe ju për këtë nuk bëni asgjë.”**

Gazeta New York Times në një artikull të saj shkruan: **“Pothuajse një në çdo 5 gra nëpunëse në organizatat amerikane, përballen me dhunë seksuale. Femrat përdhunohen edhe në ushtrinë amerikane. Sipas statistikave të publikuara nga Associated Press, rastet e përdhunimeve në radhët e ushtrisë amerikane përgjatë vitit 2013 janë shtuar me 50%.”**

Shkelja e të drejtave të gruas në burgjet amerikane është akoma më katastrofike Vlen të theksohet se komiteti për të drejtat e njeriut në OKB ka shprehur shqetësimin lidhur me përdorimin e prangave ndaj femrave shtatzënë dhe ka kërkuar ndërprerjen e këtij veprimi.

Dy vjet më parë **Nikole Guerrero**, në kohën kur ishte shtatzënë është detyruar nga policia që të përballojë dënimin në qelitë e izolimit. Kjo grua humbi fëmijën e saj

për shkak të kushteve të rënda që mbizotëronin në procesin e lindjes. Të tilla veprime jo vetëm që bien ndesh me të drejtat civile, politike ato janë kundër konventave të nxjerra nga OKB kundër torturës e cila përkufizohet në çdo lloj mjeti që sjell dhimbje dhe vuajtje fizike dhe shpirtërore tek njeriu.

Një tjetër rast i shkeljes së të drejtave të gruas në Amerikë, është distancimi i saj nga roli i bashkëshortes dhe nënës dhe devijimit të saj në anë të roleve dhe lidhjeve të përshtatshme dhe jashtë natyrës së gruas.

Sot rrjedha feministe dhe sidomos ajo e ekstremit të djathtë, femrave në Amerikë u imponon idenë që të larg-

ohen nga familja e tyre pasi ky largim krijon kushtet për të patur një jetë të shëndetshme dhe të lirë.

Divorcohuni nga burrat tuaj dhe bëhuni homoseksuale. Divorci është veprim pozitiv dhe çlirim i njeriut nga martesë. Këto janë thirrjet që u bëhen femrave në Perendim nga ana e rrjedhës feministe, mirëpo të tilla slogane kanë dëmtuar rëndë gjendjen shpirtërore dhe fizike të shumë femrave tek të cilat ekziston nevoja për të patur fëmijë dhe për luajtur rol në familje. Kohë më parë gazeta amerikane **News Week** ka shkruar:

Marrja e divorcit në Amerikë është aq lehtë sa të hipësh në taksi.



Danielle Krittenden, shkrimtare dhe gazetare kanadeze me banim në Amerikë kohë më parë në një fjalim të saj ka thënë: “Ne në krahasim me brezin e kaluar në Amerikë divorcohemi më shumë ose nuk martohemi kurrë. Ne në përgjithësi bëhemi me fëmijë përpara sesa të martohemi. Ne përballemi me rrezikun e sëmundjeve seksuale dhe jemi bërë pre e abortit. Unë shumë herë kam dëgjuar nga goja e grave të suksesshme se ne kemi më pak të drejtë zgjedhjeve në krahasim me nënat tona. Disa prej tyre sytë i hapin në moshën 35 vjeçare dhe atëherë vërejnë se janë beqare, nuk kanë kohë për të patur fëmijë dhe nuk gjejnë asnjë burrë të përshtatshëm për tu martuar.”




Suzan Faludi, shkrimtare dhe gazetare nga Amerika shkruan: “Pas gjithë kësaj hurreje dhe gëzimit për fitoren e femrave në Amerikë dhe pas lajmeve që publikohen mbi atë se rezistenca për arritjen e të drejtave të femrës ka dhënë rezultat, qëndron një tjetër realitet dhe mesazh. Ky mesazh, femrave u thotë: Sot ju jeni të lira dhe të barabarta, mirëpo kurrë më parë nuk keni qenë kaq të mjera. Këto pohime janë faktor tregues për ata të cilët besojnë se perëndimit përbëjnë çerdhen e lirisë dhe të të drejtave të njeriut, pasi kjo liri ka dëmtuar rëndë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e femrave.”

EURODEPUTETETJA E PARE ME SHAMI

Pashiç, Bishiç ka lindur në Jesenice , Slloveni nga një familje muslimane e cila kishte emigruar nga Bosnja. Pavarësisht se u trajtua si e huaj ajo fitoi një arsim të mirë. Pas mbarimit të shkollës ajo e pati të vështirë për tu punësuar pasi mbante shamin në kokë. Por, Faila Pashiç, pasi mbaroi studimet e larta akademike, u inkadrua në shumë konferenca me karakter lokal e ndërkombëtar si dhe mori pjesë në shumë misione huamnitare në Slloveni, Genevë dhe Kosovë.

Ndonëse, konsiderohej si një grua nga Sllovenia, me origjinë ballkanike dhe karakteristikë e dukshme ishte shamia në kokë dhe diskriminohej si qytetare e dorës së dytë ajo nuk u dorëzua dhe luftoi për të drejtat e saj. Pashiç arriti të fitonte besimin e Parlamentit European, pavarësisht se trajtohej e huaja dhe me shami në kokë, u bë eurodeputete.



KURIOZITETE




**DREDHËZA KA MË SHUMË
VITAMINË C SE SA PORTOKALLI**



**DËNIMI MË I MADH PËR BURGIM ISHTE
384911 VJET PËR NJË POSTIER I CILI
NUK I DËRGOI RRETH 40000 LETRA.**



**LEONARDO DAVINÇI PATI
AFTËSINË QË NË TË NJËJTËN
KOHË TË SHKRUAJ ME NJË
DORË NDËRSA ME DORËN
TJETËR TË VIZATOJ**



**NJË IPHONE 5S
KA PROCESOR 1300
HERË MË TË SHPEJTË
SESA KOMPJUTERI I
PARË QË U DËRGUA
NË HËNË**



**NJË CIGARE MUND TA
SHKURTOJ JETËN E
DUHAN PIRËSIT PREJ
5 - 11 MINUTA**



**NJË FUTBOLLIST NË NJË
NDESHJE VRAPON ME
NJË MESATARE PREJ 11.3
KILOMETRA**

Nënës ime

Një pikë loti, sot gjendet në syrin tim
Një mall pa fund, sot gjendet në shpirtin tim
Një vetmi kam thellë në zemrën time
Athua vallë ku je nëna ime ?

Të kërkoj, në rrugë pa fund
Të kërkoj, në mes të njerëzve
Të kërkoj, në qiellin kaltërsi
Por ti prapë nuk jam me ty.

Shpirtin po ma mbyty trishtimi
Sa më mungon, dashuria jote
Por tash e kuptova, se ku ke shkuar
Je pranë Krijuesit që jetën na ka dhuruar.

Kudo e ndjej aromën tënde
Kudo kërkoj ngrohtësinë tënde
Nënë, kurrë nuk do të harroj
Ti në zemrën time jeton.
Je sikur një lule, që në pranverë fillon të lulëzoj.

1 ETAPË NDRYSHIM

Kur njeriu më i çmuar i jetës, mori një rrugë pa kthim, filloi ndryshimi më i madh që ndonjëherë ka ndodhur në jetën time. Ishte kohë kur shumë gjëra u kthyen mbrapsht. Isha e re dhe kisha nevojë për një dashuri të një nëne, pra, dashuri prindërore. Kohë të vështira, momente jo të këndshme që kurrë nuk do të harrohen gjithmonë do kujtohen. Etapë e paharrueshme, ndryshim tej mase. Krijimi i një kapitulli tjetër, vështirësitë që më ndiqnin çdo ditë e më shumë, mungesë e çdo gjëje sidomos e gjërave me vlerë, gjërave që kur nuk zëvendësohen. Ka momente kur qenia njerëzore kërkon vdekjen, por...! Ajo nuk vjen kur ne kërkojmë, por vetëm kur nuk e presim na del para syve.

Për një vajzë si unë që shumë shpesh mendoj dhe jetoj me mendimin dhe shpresën se do e shoh nënën time por jo sepse kjo është vetëm një pretekst që ka mbetur në kokën time. Dëshira për të pasur afër çdo herë është më e nevojshme. Vështirë pa ty, pa engjëllin tim, pa dritën e syve të mi. Kur do vijë ajo ditë, që do të shohë përsëri do të jem shumë e gëzuar, sepse do jem e sigurt dhe nuk do të frikohem se do të humbas, dhe të jem me ty përgjithmonë deri në përjetësi. Do e ndaj me ty gjithë atë dashuri që a patëm planifikuar të dyja. Do të kem afër, shumë afër, do e heq atë mall që shpirtin po ma kall. Pra do të jetë një ndryshim shumë i madh, një etapë pa masë.

Për Redaksinë e Revistës VLERE na ka shkruar nga zemra, e dashura KALTRINA SHALA nga Theranda, e cila mbeti jetime dhe pa dashuri amësore që nga fëmijëria e saj e hershme.

KËNDI “ Nga Brendia e Shpirtit”

Nëse doni të ndani shkrimet tuaja emocionale me dikë tjetër dhe poezia juaj të trokasë në më shumë zemra, nëse doni të jeni dikush dhe të fitoni një çmim (prej 100 Euro) merrni pjesë në konkursin poezisë që organizohet nga revista “VLERE”.

Punimet e juaja mund ti dërgoni në adresën elektronike E-Mail: vlere.magazine@gmail.com

DANIMARKA UBË ME XHAMINË MË TË MADHE NË VEND



Të enjten, më 19 qershor 2014, në veriperëndim të Kopenhagës u hap xhamia më e madhe në Danimarkë, duke përfshirë edhe minaren e parë në këtë vende cila ka kushtuar 150 milionë korona apo 27.200.000 dollarë, kjo u realizua me ndihmën e Katarit.

Pas shumë viteve të ngushtllëkut ku faleshin në një hapësirë të vogël, myslimanët e Kopenhagës kanë festuar hapjen e kompleksit të xhamisë së tyre e cila ka një sipërfaqe prej 6.700 metra katror, ku ka një xhami, një qendër kulturore, një studio televizive dhe një palestër sportive.

Islami është feja e dytë më e madhe në Danimarkë pas Kishës Protestante Luteriane, e cila ndiqet në mënyrë aktive nga katër të pestat e popullsisë së vendit.



GAZETARËT E VRARË NËPËR BOTË

Së paku 70 gazetarë janë vrarë në vitin 2013, duke qenë në krye të detyrës së tyre, në gjithë rruzullin tokësor, duke përfshirë këtu 29 pjesëtarë të fuqisë së shtatë të cilët kanë raportuar nga Siria dhe 10 nga Iraku, thuhet në raportin e Komitetit për mbrojtjen e gazetarëve, me seli në New York.

Gjashtë gazetarë kanë humbur jetën në Egjipt, tre nga këta të vrarë humbën jetën derisa raportonin nga demonstratat kundër rrëzimit të Muhamed Morsit më 14 gusht, gjatë kohës që forcat e sigurisë përdorën dhunën kundër demonstruesve, njofton Agjensioni AP.

“Lindja e Afërt u shëndrrua në fushëbetejë për gazetarët. Deri sa numri i gazetarëve të vrarë ka rënë në disa regjione, ndërkaq për aq është shtuar në Siri për shkak të luftës civile atje, sikur edhe në Irak, për shkak të rinisjes së konflikteve sektare”, thuhet në kumtesën e publikuar nga zëvendësi i drejtorit të Komitetit Robert Mahoni. Në shumicën e rasteve, bëhet fjalë për gazetarë të cilët kanë raportuar nga trevat në të cilat edhe kanë jetuar.

Një numër i madh i gazetarëve kanë humbur jetën deri sa raportonin nga vendi i përleshjes, mirëpo disa të tjerë humbën jetën nga ngaqë shkruanin për tema të ndjeshme, siç janë parregullësitë në polici, korrupsioni politik dhe tregtia me narkotikë. Në këto vende bëjnë pjesë Brazili, Kolumbija, Filipinet, Rusia, Pakistani dhe Bangladeshi, thuhet në kumtesën e Komitetit.

Për herë të parë në dhjetë vitet e fundit, asnjë gazetar nuk është vrarë në Meksikë. Komiteti edhe më tutje është duke punuar në zbardhjen e vdekjes së 25 gazetarëve në vitin 2013, të cilët nuk ishin përfshirë në bilansin e dhënë të 70 gazetarëve të vrarë.

F.M.

Tregime të vërteta



Një burrë ishte kthyer nga haxhi dhe po i tregonte Imam Sadikut (pqmt) si e kishte kaluar udhëtimin dhe për bashkudhëtarët. Ai lavdëronte shumë njërin prej tyre. Të gjithë ishin të kënaqur që po shoqëroheshin më një burrë të nderuar si ai. Ai gjatë tërë kohës falej dhe lutej. Sapo mbërrinim në ndonjë shtëpi, ai shkante në një cep, shtronte sexhade e tij dhe fillonte të falej.

Imami e pyeti:

“Po, kush i bënte atëherë punët e tij? Kush përkujdesej për kafshën e tij?”

Burri iu përgjigj: “Sigurisht, nderi i këtyre punëve na takonte neve, ai ishte i zënë vetëm me punët e tij të shenjta.” “Atëherë, të gjithë ju qëndroni me lart se ai”, - u përgjigj Imami.



USHQIMI I PËRBASHKËT

Sapo Profeti dhe shokët e tij ndalën te kafshët e varganit të tyre, zbritën prej tyre dhe shkarkuan ngarkesën, vendosën që të therrnin një dele për të ngrënë.

Njëri prej shokëve tha:

“Delen e ther unë.” “Lëkurën ja heq unë” - tha tjetri. “Unë do ta pjek, - ia priti një tjetër. E kështu me radhë, secili mori përsipër diçka. Kurse Profeti tha:

“Unë do të mbledh krënde nëpër shkretëtirë.

Ndërkohë, shokët iu kthyen e i thanë: “O i Dërguari i Zotit, ju nuk duhet të mundoheni, i bëjmë ne këto punë me gjithë qejf.”

“E di që ju i kryeni këto punë”, - tha Profeti - por Zoti nuk e pëlqen që robi i Tij të rrijë duarkryq mes shokëve të tij duke i dhënë privilegje vetes së tij. Pastaj shkoi drejt shkretëtirës, mblodhi shkurre e shkarpa e u kthye me krah plotë.

The Children **Need Your Help** ...Please Don't Let Them Down

To Sponsor A ZCSS Student please go to: www.my.world-federation.org/zcss

Eradicating Poverty Through Education
For Over 30 Years



ZCSS
Zainabiyah Child Sponsorship Scheme

SHEMBULL I BUKUR PËR MUSLIMAN

Këtë vit Federata Botërore - World Federation në Londer, ka tubuar një fond prej 1 milion \$ nga dhuruesit lokal të Britanisë së Madhe. Ky fond humanitar është tubuar me qëllim që tu shpërndahet mijëra njerëzve nga zonat më të trazuara të botës të cilët janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre dhe kanë nevojë për mbështetje maksimale. Situata në Irak është një nga shqetësimet më të mëdha ku ka një luftë midis injorancës dhe dijes.



Over **1.2 million** Displaced,
Over **80,000** Killed,
With **1** Hope...

What Will **You** Do?

Donate Generously: www.justgiving.com/SyriaRefugeeAppeal



SYRIAN REFUGEE APPEAL 2013

A documentary
looking at the lives
of Syrian Refugees
in Lebanon

Coming soon

 /WorldFederationKSIMC

**Syria's
Silent
Victims**



Shtëpia Botuese "DIELLI PAS REVE"



Revistën Vlera mund ta gjeni në të gjitha kiosket e Kosovës.



Kërkesë për pranimin
e revistës "VLERA"

Emri dhe mbiemri: _____
Profesioni: _____
Adresa: _____
Numri ii postës: _____ Qyteti: _____
E-maili: _____ Telefoni: _____

Revista "Vlera" Adresa: Veternik, pa nr.
Prishtinë, Kosovë.
044/049 142 038
vlera.magazine@gmail.com
www.vlera.net






Foto Simpatike



LEXUESIT TONË



E emëruan me emrin Ali sepse lindi në kohën kur Imam Aliu ndërroi jetë (u martirizua) në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit. Dhasht Zoti Aliu të jetë dashamir i Pejgamberit s.a.a. dhe Imam Aliut a.s.

Shtypshkronja - PrintingHouse

DinoGraf

Adresa: Driton Islami p.nr. Ferizaj

Shërbimet:

- Dizejn profesional
- Libra Revista, Gazeta
- Formularë
- Etiketa të ndryshme
- Katalogje dhe kalendarë
- Kartvizita
- Postera 70 x 100cm
- Reklama Ndriçuese dhe jo ndriçuese
- Reklama të neonit
- Mbishkrim dhe gravurë në lapsa shkrepëza, qelq(gota), në metal, etj.
- Mbishkrime në tekstik
- Bëjmë shtypin dhe punimin e billbordave prej metalit sipas Kërkesës
- Veshjen e veturave me reklama



mob: 044 17 19 16

e-mail: dinograf@live.com

SHTYPSHKRONJË E KOHËS • CILËSISË • KORREKTËSISË • TRADITËS

KËNDOJMË MEVLUDE PËR RASTE TË NDRYSHME:

- **MIRËNJOHJE NDAJ ZOTIT:** babina (me rastin e lindjeve), fejesa, diplomime, magjistratura, hyrjen shtëpi të reja, etj.

-**PËRKUJTIMI DHE NDERIMI TË VDEKURVE:** shtatat , katërdhjetat, gjashtë mujorin dhe një vjetorin.

MEVLUDET I KËNDOJ NË SHËPTI PRIVATE & RESTORANE VETËM NË PRANI TË FEMRAVE.

MEVLUDET I KENDON HOXHANESH IKBALLE ME PARAQITJE ARTISTIKE DHE PËRVOJË KËNDIMI 25 VJEQARE.

Në përcjellje të mevludit zërimi është gratis.

044 142 038

